



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 239 Akti

Nr. 165 Vendimi

Tiranë, më 21.06.2019

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisioni të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Pamela Qirko	Kryesuese
Brunilda Bekteshi	Anëtare
Etleđa Çiftja	Relatore

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Olsida Goxhaj, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, në datën 17 qershor 2019, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve, kati I, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Klodiana Veizi**, gjyqtare pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni Ç, D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;**

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Etleđa Çiftja, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, dëgjoi subjektin e rivlerësimit, znj. Klodiana Veizi, vëzhguesin ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, pasi shqyrtoi në tërësinë e saj

çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Klodiana Veizi, e cila në seancë dëgjimore publike kërkoi konfirmimin e saj në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT PROCEDURALE

1. Znj. Klodiana Veizi është subjekt i rivlerësimit për shkak të funksionit të saj si gjyqtare pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, referuar pikës 3 të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar” dhe ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016) i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*.

2. Në bazë të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, znj. Klodiana Veizi i është nënshtruar procesit të rivlerësimit, duke u shortuar në datën 15.1.2019 me trupin gjykues të përbërë nga komisionerët:

Pamela Qirko
Brunilda Bekteshi
Etleda Çiftja

3. Komisionerja Xhensila Pine kërkoi përjashtimin nga shqyrtimi i çështjes. Një trupë tjetër gjykuese, me vendimin e datës 7.5.2019, vendosi pranimin e kërkesës së saj duke u zëvendësuar me komisioneren Brunilda Bekteshi. Së bashku me shortimin e trupit gjykues fillestar është shortuar edhe zëvendësuesi në rast konflikti interesi.

4. Menjëherë pas hedhjes së shortit u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), sipas neneve 31 – 33 të ligjit nr. 84/2016; nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK), sipas neneve 34 – 39 të ligjit nr. 84/2016; dhe nga Inspektorati pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, sipas neneve 40 – 44 të ligjit nr. 84/2016.

5. Trupi gjykues i shortuar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (në vijim Komisioni), me vendimin nr. 1, datë 24.1.2019, pas studimit të raporteve të sipërpërmendura të vlerësimit, të hartuara nga institucionet shtetërore, vendosi të fillojë hetim administrativ të thellë dhe të gjithanshëm, sipas nenit 45, të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit; të caktojë kryesues të trupit, komisionere Pamela Qirko. Të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit.

6. Në datën 29.5.2019, trupi gjykues, me anë të vendimit nr. 2 vendosi të përfundojë hetimin paraprak për subjektin e rivlerësimit, znj. Klodiana Veizi, bazuar në relativimin mbi rezultatet e hetimit të paraqitur nga relatori i çështjes.

7. Në datën 29.5.2019, trupi gjykues me anë të postës elektronike njoftoi subjektin e rivlerësimit për: (i) rezultatet e hetimit kryesisht; (ii) kalimin e barrës së provës sipas nenit 52, të ligjit nr. 84/2016 dhe të sjellë prova për të provuar të kundërtën, nëse disponon, brenda 15 ditëve nga marrja e njoftimit me *e-mail*; (iii) njohjen me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47, të ligjit nr. 84/2016, neneve 45 – 47 dhe 35 – 40 të Kodit të Procedurave Administrative, duke paraqitur kërkesë për njohje me dosjen brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit me *e-mail*; (iv) përbërjen e trupit gjykues.

8. Në datën 6.6.2019 subjekti i rivlerësimit kërkoi shtyrjen e afatit të paraqitjes së parashtrimeve përfundimtare, duke qenë se është në pamundësi për të paraqitur në kohë aktet provuese dhe në përputhje me këto akte të parashtrorë qëndrimin e saj në lidhje me rezultatet e hetimit kryesisht. Komisioni i dha edhe 6 ditë shtesë subjektit të rivlerësimit për të paraqitur shpjegimet në lidhje me rezultatet e hetimit kryesisht.

9. Në datën 14.6.2019 subjekti i rivlerësimit dërgoi në Komision provat dhe në datën 17.6.2019 shpjegimet e saj me anë të postës elektronike.

10. Në datën 7.6.2019, me anë të vendimit nr. 3, trupi gjykues vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit, znj. Klodiana Veizi, në seancë dëgjimore në përputhje me nenin 55, të ligjit nr. 84/2016 dhe, me anë të postës elektronike subjekti i rivlerësimit u njoftua se seanca dëgjimore do të zhvillohej në datën 17.6.2019, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve, kati I, Tiranë.

11. Bazuar në pikën 1, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, znj. Klodiana Veizi, bazuar në të tria kriteret e rivlerësimit: vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale

II. SEANCA DËGJIMORE

12. Në datën 17.6.2019 u zhvillua seanca dëgjimore në prani të subjektit të rivlerësimit, në përputhje me kërkesat e nenit 55, të ligjit nr. 84/2016 dhe në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs. Në seancë subjekti i rivlerësimit u paraqit vetë personalisht.

13. Seanca dëgjimore e datës 17.6.2019 u ndërpre, për të rifilluar në datën 21.6.2019 për shpalljen e vendimit. Në përfundim të seancës dëgjimore subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

14. Subjekti i rivlerësimit, znj. Klodiana Veizi, ka qenë bashkëpunuese gjatë gjithë procesit në përputhje me nenin 48, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

15. Procesi i rivlerësimit, i cili kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.

Sipas kreve IV, V dhe VI të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”:

- i. ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të paraqitur një raport me konstatime në lidhje me vlerësimin pasuror;
- ii. DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë kontrollin e figurës së subjekti të rivlerësimit, duke paraqitur në Komision një raport me konstatimin në lidhje me përshtatshmërinë apo papërshtatshmërinë e subjekti të rivlerësimit; dhe
- iii. Inspektorati pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë është organi përkatës i vlerësimit profesional, i cili, në përfundim të shqyrtimit të dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe të pesë dokumenteve të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, përgatit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar.

16. Megjithëse sa më lart, referuar vendimit nr. 2/2017¹ të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

V. RIVLERËSIMI I PASURISË

V/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

17. Me shkresën nr. ***, datë 13.9.2018, në përputhje me nenin 33, të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, znj. Klodiana Veizi, e cila është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2004 me numër indeksi *** dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar.

18. Subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar deklaratat e interesave privatë nga viti 2004 deri në vitin 2016 dhe, referuar ligjit nr. 84/2016, ka dorëzuar në datën 30.1.2017, “Deklaratën e Pasurisë së Rivlerësimit Kalimtar, Vetting”. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe personave të lidhur, është konstatuar:

- deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
- ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- nuk ka kryer deklarim të rremë;
- subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

V/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

19. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni hetoi dhe vlerësoi të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti pranë ILDKPKI-së në “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting” të vitit 2017; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratat vjetore të deklarimit të pasurisë në ILDKPKI nga viti 2004 deri 2016; (ç) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (d) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik; (dh) provat dhe shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit, në datën 14.6.2019 provat dhe datë 17.6.2019 shpjegimet, e në vijim, deri ditën e seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

20. Komisioni hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKI-së, si dhe të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me

¹ Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas pikës 5, të nenit 179/b, të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit nr. 84/2016: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryhen vetë Komisioni gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit nr. 84/2016, parashikohet se “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezultojnë se: “Në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”

ligjin nr. 84/2016, hetim i cili konsistoi: (i) në verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur; (ii) në verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) në evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose përdorim; dhe (iv) në evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesave, të parashikuar nga pika 5, e nenit 33, e ligjit nr. 84/2016.

Personat e lidhur apo të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit që janë hetuar

21. Për efekt të procesit të rivlerësimit, personat që janë hetuar si të lidhur apo të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit janë si më poshtë vijon:

21.1 S.V., – bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit konsiderohet person i lidhur;

21.2 A.V., (vjehrra) – për shkak: (i) të qenies pronare e apartamentit ku subjekti i rivlerësimit jeton pa kundërshpërblim me familjen; (ii) të transferimit të shumës prej 13.686.000 lekësh në llogarinë e personit të lidhur/bashkëshortit të subjektit; (iii) të lëshimit të prokurës personit të lidhur; (iv) të huamarrjes së shumës prej 400.000 lekësh nga personi i lidhur.

21.3 Gj.B., – për shkak: (i) të dhënies në përdorim personit të lidhur të automjetit tip “Honda”; (ii) dhënies hua personit të lidhur/bashkëshortit të subjektit shumën prej 2.000 eurosh.

21.4 L.B. (V.) – për shkak: (i) të dhënies në përdorim personit të lidhur automjetin tip “Honda”; (ii) të transferimit të shumave të konsiderueshme nga personi i lidhur/bashkëshorti i subjektit tek znj. L.B. (V.) në llogari bankare; (iii) të lëshimit të prokurës së përgjithshme për administrimin e llogarive bankare nga personi i lidhur/bashkëshorti i subjektit në Shqipëri; (iii) të ndihmës financiare të dhënë për znj. A.V., për krijimin e llogarive bankare deri në vitin 2007.

22. Në lidhje me pasuritë dhe likuiditetet e deklaruara në “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting” të vitit 2017, nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur:

1. Apartament me sipërfaqe 70 m², lagjja “**”, Çorovodë, Skrapar**

a. Komisioni, për vërtetimin e faktit, administroi:

1.1 Deklaratën “Vetting” të vitit 2017 dhe dokumentacionin bashkëlidhur².

1.2 Dokumentacionin e administruar nga ILDKPKI-ja dhe nga Komisioni.

1.3 Dokumentacionin e administruar nga ZVRPP-ja Skrapar dhe nga “Credins Bank”³.

b. Arsytimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me ligjin e zbatueshëm

1.4 Në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ka në bashkëpronësi një apartament me sip. 70 m², nr. **** pasurie, z.k. **, ndodhur në lagjen “****”,

² Shkresa nr. **** prot., datë 25.10.2016, e ZVRPP-së Skrapar; vërtetim datë 11.2.1994, i Ministrisë së Drejtësisë; kërkesë në formë deklarate, Komisionit të Privatizimit të Banesave Shtetërore Çorovodë; kartela e pasurisë apartament, nr. pasurie ****, vol. **, f. **; kontratë hipoteke nr. **, datë 18.2.2013 me palë “Credins Bank” dhe F.M., N.M., B.M., A.K., dhe Klodiana Mema (Veizi), për krijimin e hipotekës për të garantuar shlyerjen e plotë të detyrimeve deri në vlerën e parashikuar në kontratën e kredisë afatgjatë nr. **, datë 18.2.2013. Pasuria e regjistruar në ZRPP-në Skrapar e ndodhur në z.k. **, me nr. pasurie **, vol. **, fq. **, në Skrapar, Çorovodë, lloji i pasurisë apartament me sipërfaqe 70 m² në pronësi të F.M., N.M., dhe Klodiana Mema. Kjo pasuri do të qëndrojë e bllokuar në favor të bankës për të garantuar shlyerjen e plotë të detyrimit të përcaktuar në kontratën e kredisë afatgjatë nr. **, datë 18.2.2013, me të cilën banka ka rënë dakord t'i japë B.M., kredinë bankare për një shumë 58.000 euro.

³ Përgjigje nr. **, datë 5.2.2019, e ZVRPP-së Skrapar; përgjigje nr. **** prot., datë 26.2.2019.

Çorovodë, Skrapar. Vlera 19.012 lekë, çmimi i kontratës së privatizimit, sipas shënimit të bërë në kartelën e pasurisë. Pjesa takuese: 33.3 %.

1.5 Si burim krijimi subjekti ka deklaruar ligjin nr. 7652, “Për privatizimin e banesave shtetërore”. Kjo pasuri i është blerë Ndërmarrjes Komunale Banesa Çorovodë, sipas vërtetimit noterial nr. ***, datë 11.2.1994; pasuri e vënë në hipotekë sipas shënimit të bërë në kartelë.

1.6 Nga hetimi administrativ kryesisht u konstatua se ZVRPP-ja Skrapar, me shkresën nr. *** prot., datë 5.2.2019, konfirmon se znj. Klodiana F. Veizi (Mema), ka përfituar nga ligji nr. 7652, datë 23.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore”, pasurinë apartament banimi me sip. 70 m², me nr. ***, vol. ***, f. ***, z.k. ***, Çorovodë, të cilën e ka në bashkëpronësi me z. F.T.M., dhe znj. N.A.M.

1.7 Me vërtetimin nr. ***, datë 11.2.1994, konfirmohet se babai i subjekti të rivlerësimit, z. F.M., është blerësi i këtij apartamenti nga Ndërmarrja Komunale Banesa Çorovodë, sipas ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore”.

1.8 Kjo pasuri ka kufizim në seksionin E, “vendosur garanci për kredi” për “Credins Bank” me kontratë nr. ***, datë 18.2.2013.

1.9 Referuar kartelës së pasurisë rezulton se data e regjistrimit të kësaj prone është data 21.6.1999, me pronar shtetasit F., N., dhe Klodiana Mema.

1.10 “Credins Bank”, me shkresën nr. *** prot., datë 26.2.2019, konfirmon se shtetasja Klodiana Veizi (Mema) është kliente e kësaj banke në cilësinë e dorëzantes për kredi të marrë nga shtetasi B.F.M. Kjo shtetase nuk zotëron llogari rrjedhëse individuale deri në datën 30.1.2017.

1.11 Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në vitin 2012, bashkëpronësinë për këtë apartament dhe faktin se ky apartament është vendosur *kolateral* për marrjen e një kredie bankare nga vëllai i subjekti të rivlerësimit, z. B.M.

1.12 Komisioni, nga hetimi administrativ kryesisht, bazuar në faktet e sipërpërmendura, arriti në rezultatin se:

- i. deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e administruar në dosje;
- ii. burimi i krijimit është nga burime të ligjshme, dhe provohet me dokumentacion ligjor justifikues;
- iii. subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar bashkëpronësinë mbi këtë aset në deklaratat periodike vjetore nga viti 2004 – 2011 në ILDKPKI sipas ligjit.

1.13 Deklarimet për këtë pasuri nuk janë shteruese: subjektit të rivlerësimit, pasi iu njoftuan rezultatet e hetimit, iu kërkua të japë shpjegime me sa rezultoi në pikën (iii).

1.14 Në shpjegimet e saj, subjekti i rivlerësimit deklaroi se kontrata e shitjes mban datën 11.2.1994, datë në të cilën subjekti ka qenë 14 vjeçe e 8 muaj dhe, si e tillë, pa zotësi të plotë juridike për të vepruar. Ajo sqaroi se këtë pasuri gjithnjë e ka konsideruar si pasuri të prindërve të saj dhe nuk kishte pasur dijeni që në kartelën e pasurisë ishte shënuar edhe emri i saj, fakt për të cilin kishte marrë dijeni kur prindërit e saj ishin paraqitur në ZVRPP-në Çorovodë për të filluar procedurat për vënien në hipotekë të këtij apartamenti, pasi vëllai i saj kishte aplikuar për të marrë një kredi (për blerjen e një apartamenti), dhe subjekti i rivlerësimit duhet të nënshkruante në kontratën e hipotekimit, pasi rezultonte bashkëpronare. Me marrjen dijeni të sa më sipër subjekti sqaroi se ka bërë deklarimin përkatës duke deklaruar pjesën në bashkëpronësi të këtij apartamenti në deklaratën periodike vjetore për vitin 2012. Subjekti gjithashtu, sqaroi se këtë pasuri nuk e ka konsideruar dhe as nuk ka vepruar në lidhje me të si të ishte pronare.

1.15 Në dokumentacionin shoqërues të deklaratës “Vetting”, kontrata e hipotekimit përkon me periudhën në të cilën subjekti ka marrë dijani dhe ka bërë më pas deklarinimin e pjesës së saj në bashkëpronësi të kësaj pasurie në deklaratën periodike vjetore të vitit 2012.

1.16 Komisioni, pasi shqyrtoi dhe analizoi shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti, vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka qenë në moshë të mitur në momentin e krijimit të kësaj pasurie, në momentin që ky apartament është vendosur si *kolateral* për marrjen e një kredie, subjekti i rivlerësimit është vënë në dijani për këtë pronësi. Menjëherë sapo ka marrë dijani, subjekti ka deklaruar në deklaratën periodike vjetore përkatëse pjesën takuese nga kjo pasuri. Gjithashtu, Komisioni vlerëson se kjo pasaktësi në deklarimet periodike vjetore nuk ka sjellë asnjë pasojë juridike në shtimin apo pakësimin e pasurisë së subjektit, duke qenë se ky apartament është fituar me anë të ligjit të privatizimit nga familja e subjektit.

1.17 Si konkluzion, Komisioni çmon se duken bindëse shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, lidhur me mosdeklarimin e bashkëpronësinë mbi këtë aset në deklaratat periodike vjetore nga viti 2004 – 2011 në ILDKPKI sipas ligjit.

1.18 Më tej, Komisioni vlerëson se ky mosdeklarim në deklaratat periodike vjetore të viteve 2004 – 2011 nuk ka pasur për qëllim fshehjen e bashkëpronësisë mbi këtë apartament, i cili është krijuar nga burim i ligjshëm dhe nuk ka sjellë asnjë pasojë, e cila e interpretuar në raport me deklaratën “Vetting” të vitit 2017, të mund të konsiderohet si deklarim i pasaktë, i rremë apo fshehje të pasurisë. Subjekti i rivlerësimit shpjegoi bindshëm arsyet se përse kishte ardhur ky mosdeklarim.

1.19 Sipas parashikimeve të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, neni 4, parashikon detyrimin: *“Subjektet ... detyrohen të deklarojnë në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave brenda datës 31 mars të çdo viti, gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të interesave privatë, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare si më poshtë: a) pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to, sipas Kodit Civil”.*

1.20 Po sipas ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë”, pikës 2, të nenit 40, të kreut IV, “Kundërvajtje administrative”, parashikohen kundërvajtjet administrative përkatëse se të drejtën për vendosjen e masave administrative për rastet e shkeljeve të mësipërme e ka Inspektori i Përgjithshëm.

2. Përdorimi i apartamentit me sip. 79 m², në adresën Rr. “**”, Tiranë në pronësi të znj. A.V., / vjehrra e subjektit të rivlerësimit**

a. Komisioni, për vërtetimin e faktit, administroi:

2.1 Deklaratën “Vetting” të vitit 2017 dhe dokumentacionin bashkëngjitur⁴.

2.2 Provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja dhe nga Komisioni.

⁴ Vërtetim nr. ***, datë 26.2.2001; vërtetim nr. ***, datë 26.2.2001; aktmbarim kontrate e mbajtur ndërmjet firmës “****” sh.p.k. dhe klientit A.V. lidhur me mbylljen e kontratës së shitblerjes së apartamentit nr. ***, kati i ***, Kulla “****”. Klienti pasi ka bërë shlyerjen e plotë të pagesës së kontraktuar ka marrë në dorëzim apartamentin dhe firma ka plotësuar detyrimet e saj sipas kontratës; znj. A.V. ka paguar shumën 17.624 lekë, bashkëlidhur tarifa për lidhjen me energji elektrike, ujë; kontratë sipërmarrje nr. ***, datë 7.12.1999. Çmimi i apartamentit 19.000 USD. Pagesa do të kryhet: 3.000 USD në momentin e lidhjes së kontratës; 3.000 USD në datën 31.1.2000; 3.000 USD në datën 1.3.2000; 3.000 USD në datën 1.5.2000; 3.000 USD në datën 1.7.2000 dhe 4.000 USD me marrjen e çelësit në dorëzim.

2.3 Deklarimet e subjektit dhënë Komisionit me anë të përgjigjeve të pyetjeve dhe dokumentacionit justifikues dërguar përmes postës elektronike.

b. Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me ligjin e zbatueshëm

2.4 Në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ka në përdorim të drejtën për të banuar në pasurinë apartament me sip. 79 m², me nr. ***, z.k. *** në adresën Rr. “***”, kulla ***, kati ***, me dy dhoma, kuzhinë dhe mjedise ndihmëse, në pronësi të znj. A.V., nëna e bashkëshortit të subjektit. Vlera e pasurisë sipas kontratës së sipërmarrjes datë 7.12.1999, është 19.000 USD. Vlera e pasurisë pas rivlerësimit të saj është në shumën 5.735.400 lekë.

2.5 Si burim i krijimit të kësaj pasurie subjekti ka deklaruar kontratën e sipërmarrjes datë 7.12.1999, e lidhur midis porositesit A.V. dhe sipërmarrësit shoqëria “***” sh.p.k., me seli në Qendrën e Biznesit “***”, Tiranë, regjistruar në ZVRPP-në Tiranë në datën 26.2.2001.

2.6 Nga hetimi administrativ kryesisht u konstatua se ZVRPP-ja Tiranë, me shkresën nr. *** prot., datë 6.5.2019, ka konfirmuar se znj. A.V. ka të regjistruar pasurinë apartament me sip. 79 m², me numër hipotekor ***, datë 26.2.2001, z.k. ***.

2.7 Znj. A.V. është nëna e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, vërtetuar me anë të certifikatës personale dhe familjare të paraqitur së bashku me deklaratën “Vetting” të vitit 2017.

2.8 Në këtë apartament në pronësi të znj. A.V. banon subjekti bashkë me familjen e saj pa kundërshtim, që nga momenti i lidhjes së martesës. Subjekti rezultoi se ka lidhur martesë me z. S.V., në datën 5.6.2005.

2.9 Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit dokumentacion justifikues ligjor për burimin e të ardhurave të ligjshme që kanë shërbyer për blerjen e këtij apartamenti, si dhe nëse gjatë periudhës së blerjes së këtij apartamenti ka pasur ndonjë marrëdhënie me znj. A.V.

2.10 Gjatë hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit, me anë të përgjigjeve të pyetësorit nr. 2⁵ ka deklaruar se martesë e saj ligjore me shtetasin S.V., është bërë në datën 5.6.2005. Për pasurinë e llojit apartament me sip. 79 m², ndodhur në Rr. “***” Tiranë, ku ajo dhe bashkëshorti i saj banojnë pa shpërblim, znj. A.V., është pajisur me vërtetim pronësie në vitin 2001 dhe pagesat e blerjes së apartamentit janë bërë në periudhën 1999 – 2001. Pra, është një pasuri e krijuar përpara datës 5.6.2005, kur subjekti kishte lidhur martesë me bashkëshortin e saj dhe përpara muajit tetor të vitit 2004, periudhë në të cilën subjekti ka filluar marrëdhënien e punës si gjyqtare, për shkak të të cilës është subjekt rivlerësi.

2.11 Pavarësisht sa më lart, subjekti i rivlerësimit në të njëjtin *e-mail* deklaroi se ky apartament është blerë me kursimet ndër vite të znj. A.V. dhe bashkëshortit të saj të ndjerë, z. E.V., nga të ardhurat prej punës, shpërblimeve, dietave, si dhe nga të ardhurat e përfituara të znj. A.V. si trashëgimtare e vetme e prindërve T. dhe K.Gj. Subjekti, gjithashtu, shpjegoi se si burim për blerjen e këtij apartamenti kanë shërbyer edhe të ardhurat e përfituara nga shitja e letrave me vlerë për privatizim. Në datën 21.3.1994 këto letra me vlerë – dëmshpërblim për vitet e burgut të të ndjerit E.V. pas vdekjes – janë shitur nga znj. A.V., në shumën 153.413 lekë dhe nga S.V. në shumën 230.118 lekë. Po ashtu, për blerjen e këtij apartamenti kanë shërbyer edhe të ardhurat që znj. L.B.V. i ka dhënë znj. A.V. në formë ndihme, të siguruara këto nga puna e saj në Shqipëri dhe më pas në Itali.

⁵ *E-mail* data 20.0-4.2019, ora 9:58 p.m., dërguar nga subjekti i rivlerësimit.

2.12 Subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar dokumentacion justifikues për të mbështetur deklaratimet e saj⁶.

2.13 Komisioni, pasi shqyrtoi shpjegimet dhe dokumentacionin e dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ kryesisht, konstatoi se shpjegimet e dhëna nga subjekti dhe dokumentacioni i dorëzuar nuk provonin plotësisht likuidimin e pagesave në vitin 2001 dhe, për rrjedhojë, nuk provonin mjaftueshmërinë e burimit financiar të ligjshëm për blerjen e këtij apartamenti nga personi tjetër i lidhur/znj. A.V.

2.14 Për këtë konstatim, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit administrativ në lidhje me burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie.

2.15 Subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, në lidhje me burimin e ligjshëm të të ardhurave të znj. A.V., paraqiti shpjegime dhe dokumentacion justifikues ligjor për të mbështetur deklaratimet e saj⁷.

2.16 Në lidhje me pretendimin e subjektit se znj. A.V. nuk është person tjetër i lidhur për blerjen e këtij apartamenti në vitin 2001, Komisioni vlerëson se subjekti shpjegoi dhe provoi bindshëm se znj. A.V. nuk duhet të konsiderohet person tjetër i lidhur vetëm për blerjen e këtij apartamenti në vitin 2001, duke pasur parasysh se : (i) znj. A.V. është bërë pronare e kësaj pasurie në një nga mënyrat e kalimit të pronësisë me kontratë të lidhur rregullisht, vërtetuar me kontratën e sipërmarrjes datë 7.12.1999; (ii) pagesa e kësteve të këtij apartamenti është kryer nga viti 1999 deri në vitin 2001, vërtetuar me anë të kontratës; (iii) vërtetuar me

⁶ Bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorëve prill 2019 dhe maj 2019: vërtetim nr. ***, datë 19.4.2019 i ISSH-së Fier; vendim për caktim pensioni nr. ***, datë 8.2.2003; shkresë nr. *** prot., datë 26.5.2015, nga “Credins Bank”; shkresë nr. *** prot., datë 9.5.2019 të ISSH-së Fier; vërtetim për vjetërsinë në punë për efekt pensioni për z. E.V. dhe znj. A.V.; certifikatë e përbërjes familjare të znj. A.V.; kontratë datë 20.5.2003, e Qendrës Kombëtare Shkencore të Hidrokarbureve, Fier; leje qëndrimi të znj. A.V. në shtetin italian, ku specifikohet data e hyrjes në Itali 11.4.2004; certifikatë e situatës familjare dhe e rezidencës, lëshuar Citta di Rivalaro Canavese, datë 11.11.2015, e vlefshme për një periudhë 6-mujore që nga data e lëshimit, ku konfirmohet se znj. A.V. është e regjistruar për periudhën 27.10.2004 – 28.12.2005 në adresën *** n. ***; për periudhën 29.12.2005 – 11.11.2015 në adresën *** n. ***; urdhërzhirime të Bankës Kombëtare të Shqipërisë për shitjen e letrave me vlerë për privatizim nga llogaria e znj. A.V., datë 21.3.1994 dhe urdhërzhirim nga llogaria e z. S.V., datë 21.3.1994; ekstrakte elektronike të të ardhurave të znj. L.V. në Itali për periudhën 1999 – 2006 dhe të të ardhurave të z. Gj.B. për periudhën 1999 – 2019; kopje e kartës së identitetit të znj. L.V. dhe z. Gj.B.; certifikatë “CUD 2013” për të ardhurat e përfituara në shtetin Italian nga Gj.B. gjatë vitit 2012; deklaratë “Persone Fische 2013” për të ardhurat e përfituara në shtetin italian nga znj. L.V. gjatë vitit 2012; vërtetim nga Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Mjekësisë ku konfirmohet se L.V., studente e vitit të III, ka përfutuar bursë të plotë si e përndjekur; vërtetim datë 3.12.1991 nga Hetuesia e Rrethit Fier; vërtetim datë 29.4.1991 nga N. I. Ushqimore Fier.

⁷ Deklaratë noteriale nr. ***, datë 14.6.2019; shkresë nr. *** prot., datë 7.6.2019 e Drejtorisë së Përgjithshme të “Raiffeisen Bank”; dokumentacionin që vërteton të ardhurat e znj. L.B. dhe z. Gj.B. të vërtetuara me vulë apostile; librezë pensioni, nr. ***, nga Dega e Sigurimeve Shoqërore Shtetërore; shkresë e Postës Shqiptare, Filiali Fier; shkresë datë 7.6.2019 e Bashkisë Fier; vërtetim datë 26.12.2001, i Filialit Elektrik Fier; kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 7.6.2019 nga “Raiffeisen Bank”; vërtetim datë 3.12.1991, të Hetuesisë së Përgjithshme, Rrethi Fier; vërtetim nr. ***, datë 6.12.1991, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier; librezë pensioni nr. ***; mandatpagesë për bashkëpunim për z. E.V.; vërtetim, Filiali Elektrik Fier për periudhën e punësimit të z. S.E.V.; urdhërzhirim i brendshëm datë 21.3.1994, i Bankës Kombëtare të Shqipërisë për shitjen e letrave me vlerë për privatizim nga llogaria e z. S.V.; urdhërzhirim i brendshëm datë 21.3.1994 i Bankës Kombëtare të Shqipërisë për shitjen e letrave me vlerë për privatizim nga llogaria e znj. A.V.; vërtetim datë 23.7.2001 i Bashkisë Fier; kartelë pensioni për znj. A.V.; vendim nr. ***, datë 30.11.1993, i Kryesisë së Këshillit të rrethit Fier; deklaratë zëvendësuese e aktit noterial nga z. Gj.B. dhe znj. L.B.; kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 9.5.2019 nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Dega Rajonale Fier; aktverifikimi i vjetërsisë në punë para vitit 1994; kthim përgjigjeje nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Dega Rajonale Fier, si edhe fotokopje të njehsuar me origjinalin të dosjes së pensionit me nr. ***, vendim për caktim pensioni nr. ***, datë 8.2.2003; fotokopje e librezës së punës së znj. A.V.; shkresë nga “Credins Bank” për pagesat e pensioneve në bankë; fletë përlllogaritje pensioni; kërkesë për pension; vërtetim nga Dega e Standardeve dhe Cilësisë Fier; vërtetime nga Dega Instituti i Naftës dhe Gazit Fier; vërtetim (pa punëdhënëse), për bazën e vlerësueshme dhe pagën *neto* mesatare për periudhën 1.1.2002 – 31.12.2002.

dokumentacionin e administruar ky apartament rezultoi i regjistruar në ZVRPP-në Tiranë në datën 26.2.2001; (iv) subjekti i rivlerësimit ka lidhur martesë ligjore me djalin e znj. A.V. në datën 5.6.2005, vërtetuar me anë të certifikatës së martesës.

2.17 Sipas parashikimeve të pikës 14, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016: “*Persona të tjerë të lidhur janë personat fizikë ose juridikë, që duket se kanë ose kanë pasur lidhje interesi me subjektin e rivlerësimit, komisionerin, gjyqtarin ose komisionerin publik që rrjedh nga një interes pasuror ose çdo marrëdhënie tjetër biznesi*”, ndërkohë që lidhja e subjektit me znj. A.V. është për shkak të martesës së subjektit me djalin e saj, z. S.V., por nuk është lidhje nga ato që ky ligj kërkon për efekt të rivlerësimit të pasurisë.

2.18 Po t’i referohemi nenit të cituar më lart, të interpretuar në lidhje me blerjen e këtij apartamenti në vitin 2001, nuk provohet ekzistenca e ndonjë marrëdhënie interesi ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe znj. A.V., pasi subjekti ka lidhur martesë me djalin e znj. A.V. në datën 5.6.2005.

2.19 Pra, në vitin 2001 mungon lidhja midis subjektit të rivlerësimit dhe znj. A.V., në lidhje me blerjen e këtij apartamenti, si në aspektin kohë, por dhe në aspekt të ndonjë interesi pasuror ose të ndonjë marrëdhënieje biznesi në vitin e blerjes së apartamentit.

2.20 Pavarësisht sa më lart, subjekti paraqiti dokumentacion ligjor justifikues në lidhje me burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie nga znj. A.V. deri në vitin 2001.

2.21 Pas analizimit dhe vlerësimit të provave të paraqitura, Komisioni kreu analizën financiare si më poshtë vijon:

	Përshkrimi	Periudha 1994 – 2000
1	Pasuri	2,677,753
	Apartament 79 m ² , pallatet ***, Rr. “***”, vlerë 19,000 USD	2,677,753
2	Të ardhura	2,926,796
	Të ardhura nga pagat, A.V., 1994 – 2000	1,270,921
	Të ardhura nga shitja e letrave me vlerë për privatizim	613,649
	Të ardhura nga kthimi i pagave të sekuestruara, E.V.	21,578
	Të ardhura të deklaruara si ndihmë nga të afërm (800,000 – 21,578 – 383,531 – 230,118)	164,773
	Të ardhura nga shitja e karikaturave, E.V.	855,875
	Të ardhura nga pensioni familjar 10.6.1993 – 31.12.1994 (deri në momentin që fëmijët jetonin me nënën)	46,360
3	Shpenzime	671,748
	Shpenzime jetese 1994 – 2000 ⁸	671,748
	DIFERENCA (TË ARDHURA – PASURI – SHPENZIME 2 – 1 – 3)	-422,705

2.22 Nga vlerësimi i provave të paraqitura, Komisionit i rezultoi se znj. A.V. ka një mungesë të pajustificuar me burim të ligjshëm në shumën 422.705 lekë, duke mos marrë në konsideratë: (i) të ardhurat nga vendimi i Hetuesisë së Përgjithshme për kthimin e pagave të z. E.V. për periudhën 6.2.1986 – 26.3.1991; (ii) të ardhura nga puna si përkthyes në Kishën Katolike pasi për këto dy burime, subjekti nuk kishte paraqitur dokumentacion justifikues ligjor; dhe (iii) të ardhura nga ndihma e së bijës (L.B. dhe Gj.B.), pasi për këtë burim, subjekti nuk përcaktoi vlerën e kontribuar.

⁸ Saktësuar me deklaratimet e subjektit për përbërjen familjare ndër vite.

2.23 Në përfundim, Komisioni çmon se subjekti i rivlerësimit shpjegoi dhe provoi me dokumentacion justifikues ligjor se apartamenti i përdorur nga ajo dhe familja e saj: (i) ishte likuiduar dhe blerë nga viti 1999 – 2001; (ii) ishte regjistruar në regjistrat publik të ZVRPP-së Tiranë në vitin 2001; (iii) subjekti i rivlerësimit kishte përdorur këtë apartament pothuajse 4 vjet pasi ajo kishte lidhur martesë me djalin e znj. A.V. në datën 5.6.2005; (iv) subjekti i rivlerësimit për aq sa ishte e mundur paraqiti dokumentacion provues ligjor për brumin e krijimit të blerjes së këtij apartamenti nga znj. A.V.

2.24 Më tej Komisioni, çmon se çdo pasuri, që është objekt deklarimi në deklaratën e pasurisë “Vetting”, i nënshtrohet kontrollit të plotë mbi vërtetësinë, saktësinë e deklarimit dhe ligjshmërinë e burimeve të krijimit, pa asnjë dallim dhe kufizim, i artikuluar ky sipas kriterit të kohës së krijimit apo çdo lloj kriteri tjetër përcaktues. Nuk parashikohet ndonjë normë juridike, sipas së cilës të vendosen kritere vlerësimi, lidhur me pasuritë e subjekteve dhe personave të lidhur, me qëllim përfshirjen apo përjashtimin e tyre nga objekti i kontrollit të organeve të rivlerësimit, sipas nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV, të ligjit nr. 84/2016.

2.25 Në lidhje me përdorimin e këtij apartamenti nga ana e subjektit të rivlerësimit dhe familjes së saj, znj. A.V. konsiderohet person tjetër i lidhur sipas ligjit nr. 84/2016, pasi ka një marrëdhënie interesi jo vetëm në dukje, por të konfirmuar me znj. A.V., duke qenë se subjekti i rivlerësimit përdor pa kundërshtim apartamentin ku znj. A.V. është pronare, në kuptim të pikës 14, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016.

2.26 Në këto kushte, Komisioni pyeti subjektin e rivlerësimit mbi shkaqet e përdorimit të këtij apartamenti pa kundërshtim. Subjekti i rivlerësimit deklaroi se personi tjetër i lidhur/A.V. është nëna e bashkëshortit të saj, z. S.V., pjesëtari i vetëm i familjes V. që jeton Shqipëri. Më tej subjekti deklaroi si shkak për përdorimin e këtij apartamenti pa shpërblim, faktin që personi tjetër i lidhur/znj. A.V. banonte dhe ishte me leje qëndrimi në shtetin Italian. Më tej subjekti deklaroi se personi tjetër i lidhur jetonte me familjen e vajzës së saj znj. L.V.(B.), ku kjo e fundit dhe bashkëshorti i saj, z. Gj.B., janë nënshtetas Italian dhe me banim në Itali që nga viti 1999 e në vijim. Për të gjitha deklaratimet e saj mbi shkaqet e përdorimit pa shpërblim të apartamentit, subjekti i rivlerësimit paraqiti dokumentacion ligjor justifikues.⁹

2.27 Referuar në sa më lart, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit shpjegoi bindshëm arsyet e përdorimit të këtij apartamenti pa kundërshtim, duke paraqitur dhe prova bindëse të cilat vërtetojnë deklaratimet e saj.

3. Kontratë depozite ekstra lidhur në datën 5.6.2015, me “Raiffeisen Bank”

a. Komisioni, për vërtetimin e faktit, administroi:

3.1 Deklaratën “Vetting” të vitit 2017 dhe dokumentacionin bashkëlidhur¹⁰.

3.2 Dokumentacionin e administruar nga të gjitha bankat e niveli të dytë¹¹.

3.3 Shkresën e administruar nga “Raiffeisen Bank”.¹²

b. Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me ligjin e zbatueshëm.

⁹ Certifikatë familjare dhe e rezidencës, datë 11.11.2015, lëshuar Citta di Rivalaro Canavese.

¹⁰ Kontratë depozite ekstra lidhur në datën 5.6.2015, me palë “Raiffeisen Bank” dhe Klodiana Veizi; njoftim debitimi, datë 5.6.2015, “Raiffeisen Bank”; formë autorizimi për pagesa periodike, datë 5.6.2015; formë autorizimi për pagesa periodike, datë 23.9.2016, nxjerrje e llogarisë në “Raiffeisen Bank”, në emër të znj. Klodiana Veizi për llogarinë nr. ***, për periudhën 29.1.2016 – 9.1.2017. Gjendja e llogarisë datë 24.1.2017 në vlerën 141,054.17 lekë.

¹¹ Kërkesë, nr. *** prot., datë 17.1.2019, drejtuar të gjitha bankave të nivelit të dytë.

¹² Përgjigje nr. *** prot., datë 23.1.2019, nga “Raiffeisen Bank”.

3.4 Në deklaratë “Vetting” të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit deklaroi se ka lidhur një kontratë depozite ekstra në datën 05.06.2015, me “Raiffeisen Bank”, për periudhën 7.7.2015 – 7.7.2016, rinovuar me kontratën në datën 23.9.2017, për periudhën 7.10.2016 – 7.10.2017. Pjesa takuese: 100%.

3.5 Si burim krijimi, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ardhurat nga paga, në formën e mbajtjes së shumës 12.000 lekë nga llogaria e pagës e cila është llogaria rrjedhëse me nr. ***, në llogarinë përfituese që mban nr. **. Gjendja e llogarisë në fjalë nr. *** në datën 24.1.2017, sipas nxjerrjes së llogarisë të bërë në këtë datë është 141.054,17 lekë.

3.6 Nga hetimi administrativ kryesisht, u konstatua se në lidhje me burimin e krijimit, kreditimet në këtë llogari vijnë nga transfertat periodike nga llogaria e pagës së subjektit.

3.7 Komisioni, pasi shqyrtoi dhe analizoi provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit dhe ato të administruara gjatë hetimit, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të saktë dhe në përputhje me ligjin, si dhe ka burime financiare me dokumentacion justifikues ligjor për këto të ardhura të deklaruara.

4. Llogari rrjedhëse në vlerën 45.645,13 lekë

a. Komisioni, për vërtetimin e faktit, administroi:

4.1 Deklaratën “Vetting” të vitit 2017 dhe dokumentacionin bashkëlidhur¹³.

4.2 Dokumentacionin e administruar nga të gjitha bankat e niveli të dytë¹⁴.

4.3 Shkresën e administruar nga “Raiffeisen Bank”.¹⁵

b. Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me ligjin e zbatueshëm

4.4 Në deklaratë “Vetting” të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit deklaroi se ka gjendje të llogarisë rrjedhëse në “Raiffeisen Bank” me nr. ***, llogaria e pagës pas kreditimit të pagës në muajin janar të datës 24.1.2017, në vlerën 45,645.13 lekë. Pjesa takuese: 100 %.

4.5 Si burim krijimi, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ardhurat nga paga.

4.6 Nga hetimi administrativ kryesisht, u konstatua se, sipas lëvizjeve të llogarive bankare të përcjella me shkresën nr. *** prot., datë 23.1.2019, nga “Raiffeisen Bank” konfirmohet në emër të znj. Klodiana Veizit ka llogari rrjedhëse me gjendje llogarie në vlerën 45,645.13 lekë në datën 24.1.2017.

4.7 Në lidhje me burimin e krijimit, subjekti i rivlerësimit ka depozituar dokumentacion ligjor justifikues nga punëdhënësi në lidhje me pagat që kanë shërbyer si burim për krijimin e kësaj depozite. U konstatua që kreditimet në këtë llogari vijnë nga transfertat e pagës së subjektit.

4.8 Nga analiza financiare e kryer nga Komisioni në kohën e krijimit të kësaj gjendje llogarie ka pasur të ardhura, pasuri dhe shpenzime (referuar tabelës në pikën 16.7)

4.9 Komisioni, pasi shqyrtoi dhe analizoi provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit dhe ato të administruara gjatë hetimit, arrin në përfundimin se subjekti ka bërë deklaram të saktë

¹³ Vërtetim nr. *** prot., datë 17.10.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë; vërtetim nr. *** prot., datë 14.10.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë; vërtetime për bazën e vlerësueshme dhe pagën *neto* mesatare për periudhën 2.6.2007 deri më 21.2.2008 dhe 16.2.2012 – 31.1.2013; vërtetim nr. *** prot., datë 23.1.2017, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës.

¹⁴ Kërkesë nr. *** prot., datë 17.1.2019, drejtuar të gjitha bankave të nivelit të dytë.

¹⁵ Përgjigje nr. *** prot., datë 23.01.2019, nga “Raiffeisen Bank”.

dhe në përputhje me ligji, si dhe ka burime financiare me dokumentacion justifikues ligjor për krijimin e kësaj gjendje llogarie në shumën 45.645,13 lekë.

5. Gjendja e llogarisë në “Raiffeisen Bank” në euro, me vlerë 0 euro

a. Komisioni, për vërtetimin e faktit, administroi:

5.1 Deklaratën “Vetting” të vitit 2017 dhe dokumentacionin bashkëlidhur.

5.2 Dokumentacionin e administruar nga të gjitha bankat e niveli te dytë¹⁶.

5.3 Shkresën e administruar nga “Raiffeisen Bank”¹⁷.

c. Arsytimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me ligjin e zbatueshëm

5.4 Në deklaratë “Vetting” të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit deklaron se ka gjendje të llogarisë rrjedhëse me nr. *** në euro, në “Raiffeisen Bank”, llogari me të cilën nuk është kryer asnjë veprim kredie apo debie, që nga momenti i hapjes. Vlera: 0 euro. Pjesa takuese: 100 %.

5.5 Sipas lëvizjeve të llogarive bankare të përcjella nga “Raiffeisen Bank”, konstatohet se në këtë llogari ka dy veprime: transfertë nga znj. F.M. (motra e subjektit të rivlerësimit) në datën 17.9.2013 shuma 800 euro; dhe tërheqje *cash* nga subjekti në datën 20.9.2013, shuma: 800 euro.

5.6 Nga hetimi administrativ kryesisht, u konstatua se ka mospërputhje midis deklaramit të subjektit dhe dokumentacionit të administruar nga “Raiffeisen Bank”, pasi në deklaratën “Vetting” subjekti deklaron se nuk është kryer asnjë veprim kredie apo debie në këtë llogari, ndërkohë që nga dokumenti i administruar nga “Raiffeisen Bank” rezulton se ka dy veprime, një kreditim dhe një debitim.

5.7 Subjektit iu kërkua të japë shpjegime me sa rezultoi gjatë hetimit administrativ e cila shpjegoi se është një gabim material, deklarimi i saj lidhej me gjendjen në këtë llogari në fillim dhe fund të çdo viti nga momenti i hapjes së llogarisë e në vijim. Në lidhje me veprimin e kryer në këtë numër llogarie është një shumë në euro e derdhur nga motra e saj e cila punonte si mjeke në Çorovodë, për kryerjen për llogari të saj të pagesave në Tiranë. Subjekti paraqiti si provë vërtetime nga sigurimet shoqërore në lidhje me znj. F.M.¹⁸

5.9 Komisioni, pasi shqyrtoi dhe analizoi provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit dhe ato të administruara gjatë hetimit çmon se shpjegimet e subjektit duken bindëse dhe të bazuara në prova.

6. Depozitë bankare në “ProCredit Bank” në emër të K.V. (vajzës së subjektit) në lekë

a. Komisioni, për vërtetimin e faktit, administroi:

6.1 Deklaratën “Vetting” të vitit 2017 dhe dokumentacionin bashkëlidhur.

6.2 Dokumentacionin e administruar nga të gjitha bankat e niveli te dytë¹⁹.

¹⁶ Kërkesë nr. *** prot., datë 17.1.2019, drejtuar të gjitha bankave të nivelit të dytë.

¹⁷ Përgjigje nr. *** prot., datë 23.1.2019, nga “Raiffeisen Bank”.

¹⁸ Vërtetim nr. *** prot., datë 30.5.2019, nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Berat, për bazën e vlerësuar të znj. F.M., periudha 2012 – 2017; vërtetim nr. *** prot., datë 30.5.2018 nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Berat, Qendra Shëndetësore Çorovodë, për kontributin e derdhur nga znj. F.M. për vitin 2011.

¹⁹ Kërkesë nr. *** prot., datë 17.1.2019, drejtuar të gjitha bankave të nivelit të dytë.

6.3 Shkresën e administruar nga “ProCredit Bank”²⁰.

b. Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me ligjin e zbatueshëm

6.4 Në deklaratë “Vetting” të vitit 2017, subjekti deklaroi se disponon një depozitë bankare në “ProCredit Bank” në emër të K.V. (vajza e subjektit) në lekë, hapur në datën 2.2.2008, dhe llogari kursimi “****” në datën 22.10.2016.

6.5 Si burim krijimi subjekti deklaroi se kanë shërbyer kursimet nga paga në shumën fillestare 50.000 lekë + interesat. Vlera: 78,835.44 lekë. Pjesa takuese: 100% me të drejtë administrimi. Subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar në ILDKPKI kopje të librezës së kursimeve cila konfirmon këtë situatë.

6.6 Nga hetimi administrativ kryesisht u konstatua se sipas lëvizjeve të llogarive bankare të përcjella nga “ProCredit Bank”, kjo depozitë është krijuar fillimisht me dy depozitime cash në llogarinë e kursimeve me numër ***, përkatësisht vlera 20.000 lekë në datën 2.2.2008 dhe vlera 30.000 lekë në datën 14.6.2008.

6.7 Nga analiza financiare rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar shpenzimet e kryera dhe shtesën në kursime përgjatë vitit 2008 (referuar tabelës në pikën 16.7).

6.8 Komisioni, pasi shqyrtoi dhe analizoi provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit dhe ato të administruara gjatë hetimit, arrin në përfundimin se subjekti ka bërë deklaram të saktë dhe në përputhje me ligjin, si dhe ka burime financiare me dokumentacion justifikues ligjor për këto të ardhura të deklaruara.

7. Depozitë bankare në “ProCredit Bank” në emër të K.V. (vajza e subjektit) në euro

a. Komisioni për vërtetimin e faktit administroi:

7.1 Deklaratën “Vetting” të vitit 2017 dhe dokumentacionin bashkëlidhur²¹.

7.2 Dokumentacionin e administruar nga të gjitha bankat e niveli të dytë²².

7.3 Shkresën e administruar nga “ProCredit Bank”²³.

b. Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me ligjin e zbatueshëm

7.4 Në deklaratë “Vetting” të vitit 2017 subjekti i rivlerësimit deklaroi se disponon një depozitë bankare në “ProCredit Bank” në emër të K.V. (vajza e subjektit) në euro, llogari e kursimit “****”.

7.5 Si burim krijimi subjekti deklaroi se ka shërbyer kursimet nga paga, në shumën fillestare 500 euro, hapur në datën 2.2.2008 llogari me të cilën nuk janë kryer veprime gjendja e të cilës në datën 26.10.2016 së bashku me interesat është 545.20 euro. Pjesa takuese: 100 % me të drejtë administrimi.

7.6 Nga hetimi administrativ kryesisht u konstatua se sipas lëvizjeve të llogarive bankare të përcjella nga “ProCredit Bank” janë kryer dy depozitime *cash* në llogarinë e kursimeve me numër ***, përkatësisht vlera 300 euro në datën 2.2.2008 dhe vlera 200 euro në datën 14.6.2008.

²⁰ Shkresa nr. *** prot., datë 25.1.2019 nga “ProCredit Bank”.

²¹ Depozitë në euro, datë 2.2.2008, për znj. K.V. në “ProCredit Bank” me përfaqësues ligjore S.V. dhe Klodiana Veizi.

²² Kërkesë nr. ***, datë 17.1.2019, drejtuar të gjitha bankave të nivelit të dytë.

²³ Shkresa nr. *** prot., datë 25.1.2019 nga “ProCredit Bank”.

7.7 Nga analiza financiare duket se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar shpenzimet e kryera dhe shtesën në kursime përgjatë vitit 2008 (referuar tabelës në pikën 16.7).

7.8 Komisioni, pasi shqyrtoi dhe analizoi provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit dhe ato të administruara gjatë hetimit, arrin në përfundimin se subjekti ka bërë deklaram të saktë dhe në përputhje me ligjin, si dhe ka burime financiare me dokumentacion justifikues ligjor për këto të ardhura të deklaruara.

8. Automjet në përdorim i tipit “HONDA GA3”, në pronësi të z. Gj.B.

a. Komisioni, për vërtetimin e faktit, administroi:

8.1 Deklaratën “Vetting” të vitit 2017 dhe dokumentacionin bashkëlidhur²⁴.

8.2 Provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja dhe nga Komisioni.

8.3 Deklarimet e dhëna Komisionit me anë të përgjigjeve të pyetjeve dhe dokumentacionit justifikues përmes postës elektronike.

b. Arsytimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me ligjin e zbatueshëm

8.4 Në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit, deklaroi në përdorim autoveturë, e tipit “HONDA, GA3”, LOGO, viti i prodhimit 2000, B9, e mbyllur me 3 dyer, gri e hapur, automatike, dhënë në përdorim nga pronari Gj.M.B., bashkëshorti i L.B. (motra e bashkëshortit të subjektit), me prokurë të posaçme subjektit dhe bashkëshortit z. S.V. Vlera: 700 euro.

8.5 Burimi për krijimin e këtij automjeti nga huadhënësi nuk është deklaruar.

8.6 Nga hetimi administrativ kryesisht u konstatua se DPSHTRR-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 24.7.2017, nuk konfirmon automjet në pronësi aktive në emër të shtetasve Klodiana dhe S.V.

8.7 Dokumentacioni i zhdoganimit të mjetit (deklarata doganore nr. ***), me eksportues “****” dhe importues z. Gj.B. mban datën 11.10.2015.

8.8 Nga hetimi i dokumentacionit të administruar rezulton se automjeti është dhënë në përdorim me prokurë të posaçme me nr. **, datë 14.10.2015, subjektit dhe bashkëshortit të saj, ndërsa certifikata e pronësisë është lëshuar në datën 26.10.2015. Në prokurën e posaçme, është shënuar targa **, e cila sipas dokumentacionit të dorëzuar nga subjekti është targa fillestare e këtij automjeti përpara zhdoganimit.

8.9 Pas kontrollit në AMF rezulton se z. Gj.B. është policëmbajtës (përdorues) për herë të parë për periudhën 28.10.2017 – 27.10.2018, si dhe rezulton se subjekti dhe bashkëshorti i saj janë policëmbajtës (përdorues) për periudhat 26.10.2015 – 25.10.2016; 26.10.2016 – 25.10.2017; 28.10.2017 – 27.10.2018.

²⁴ Shkresa datë 25.10.2016 e DRSHTRR-së Fier; bashkëlidhur: urdhërçlirimi në emër të z. Gj.B. për automjete të përdorura; dokument zhdoganimi i automjetit; certifikatë pronësie e automjetit “Honda”, me targë **, prokurë e posaçme nr. **, datë 14.10.2015 me përmbajtje: “Gj.B. me vullnet të lirë dhe të plotë deklaroj se ka në pronësi automjetin e markës “Honda”. Me anë të këtij akti emëroj përfaqësues të posaçëm shtetasit S.V. dhe Klodiana Veizi, të cilëve të dy së bashku ose veç e veç ju jap të drejtë që të përdorin mjetin e përshkruar më lart brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për një afat kohor të papërcaktuar...”; faturë tatimore, datë 25.10.2016, Drejtoria Rajonale Fier, për klientin Gj.B.; certifikatë pronësie automjeti, me targë **, e tipit “Honda”, në pronësi të shtetasit Gj.B., Kuçovë, Berat; certifikatë familjare, lëshuar në datën 24.1.2017.

8.10 Nga analizimi i të ardhurave të z. Gj.B., dërguar nga subjekti i rivlerësimit në përgjigje të pyetësorit nr. 3, rezultoi se ka dokumentacion ligjor justifikues në lidhje me shumën prej 700 eurosh për blerjen e këtij automjeti.

8.11 Pyetjes se përse subjekti dhe personi i lidhur/bashkëshorti nuk kanë kryer kalimin e pronësisë në emrin e tyre dhe nëse ky automjet është i vetmi automjet që përdor familja e subjektit, qoftë për transportin familjar, qoftë për transportin në Durrës ku subjekti punon, subjekti i rivlerësimit, deklaroi se autovetura e tipit “Honda GA3”, është i vetmi mjet që përdor familja e saj, dhe nuk ka mjet tjetër në përdorim. Ky mjet është blerë nga z. Gj.B. me qëllim përdorimin e tij brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë.

8.12 Komisioni, nga hetimi administrativ kryesisht bazuar në faktet e sipërpërmendura, arrin në rezultatin se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe shkresat e administruara nga hetimi administrativ kryesisht dhe ka dokumentacion ligjor justifikues për burimin e krijimit të vlerës prej 700 eurosh për blerjen e këtij automjeti.

8.13 Komisioni i kërkoi subjekti të rivlerësimit shpjegime lidhur me dyshimet se ky automjet është në pronësi të subjektit dhe bashkëshortit të saj, duke qenë se gjatë gjithë kohës ky automjet përdoret nga personi i lidhur/bashkëshorti dhe subjekti.

8.14 Subjekti i rivlerësimit solli shpjegimet e saj bashkë me dokumentacionin provues.²⁵

8.15 Pasi shqyrtoi shpjegimet e subjekti i rivlerësimit në lidhje me dyshimin e hedhur, Komisioni çmon se subjekti arriti të shpjegojë bindshëm, përtej dyshimeve, se ky automjet është në pronësi të shtetasit Gj.B. Subjekti provoi me dokumentacion blerjen e këtij automjeti, autorizimin e lëshuar për subjektin dhe bashkëshortin e saj, si dhe taksat vjetore të cilat janë paguar nga pronari i mjetit.

Subjekti i rivlerësimit dha shpjegime shteruese lidhur me arsyet e përdorimit të këtij automjeti. Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit provoi se: (i) pronar i ligjshëm i automjetit është z. Gj.B.; (ii) provohet lidhja me z. Gj.B., i cili është bashkëshorti i motrës së z. S.V.; (iii) z. Gj.B. është me lejeqëndrimi në shtetin italian dhe vjen në Shqipëri herë pas here; (iv) taksat për këtë automjet janë paguar nga pronari i mjetit, z. Gj.B.

8.16 Në përfundim subjekti i rivlerësimit shpjegoi dhe provoi bindshëm dyshimet e ngritura nga Komisioni duke i kundërshtuar ato me prova dhe fakte.

PASURITË DHE TË ARDHURAT E BASHKËSHORTIT TË SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

9. Objekti “**” në Himarë, me sip. 150 m² (120 m² nën objekt)**

a. Komisioni, për vërtetimin e faktit, administroi:

9.1 Deklaratën “Vetting” të vitit 2017 dhe dokumentacionin bashkëlidhur²⁶.

²⁵ Leje qarkullimi nr. ****, lëshuar nga DPSHTRR në emër të Gj.B.; policë sigurimi nr. ****, datë 25.10.2018, “****”; taksa vjetore e mjeteve nr. ****, datë 24.10.2018, në emër të pronarit të mjetit Gj.B.

²⁶ Vërtetim, datë 10.10.2014; vërtetim datë 24.9.2013; vërtetim datë 8.1.2015; kontratë shitjeje nr. ****, datë 3.9.2013, e pasurisë së paluajtshme të objektit “****”; procesverbal evidencim, datë 2.9.2013; shkresa nr. **** prot., datë 7.8.2013 e Ministrisë së Financave, Drejtorisë së Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike Tiranë; derdhje për thesarin, “Raiffeisen Bank”, nga A.V.; derdhje për thesarin, “Raiffeisen Bank”, nga S.V., datë 9.8.2013; formular për depozitimin e bonove të privatizimit, “Raiffeisen Bank”, datë 9.8.2013, nga shtetasi S.V.; vërtetim datë 1.1.2010; vendim nr. ****, datë 29.10.1993, i KKKP-së Vlorë; dëshmi trashëgimie nr. **** rep., datë 7.4.1990; vendimi nr. **** akti, nr. **** vendimi, datë 28.1.2008; prokurë e posaçme nr. ****, datë 6.7.2012; prokurë e posaçme nr. ****, datë 2.8.2013; autorizim nr. **** regj., datë 29.8.2013 i Ministrisë së Mbrojtjes; shkresa nr. **** regj., datë 29.8.2013 e Ministrisë së Mbrojtjes; kontratë dhurimi pasuri e paluajtshme nr. ****, datë 4.2.2015; vërtetim hipoteke datë 8.1.2015; planimetri e pasurisë.

9.2 Provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja dhe nga Komisioni²⁷.

9.3 Deklarimet e dhëna me anë të përgjigjeve të pyetjeve të Komisionit dhe dokumentacionit justifikues dërguar përmes postës elektronike.

b. Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me ligjin e zbatueshëm

9.4 Në deklaratën “Vetting” të vitit 2017 bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka deklaruar se ka në bashkëpronësi objektin “****”, në Himarë, me sip. 150 m² (120 m² nën objekt), me pjesë takuese: 33.3 %.

9.5 Si burim krijimi bashkëshorti i subjektit ka deklaruar kontratë nr. ***, datë 3.9.2013, privatizuar me të drejtën e parablerjes (ligji nr. 9235, datë 29.7.2004, ligji nr. 9967, datë 24.7.2008, ligji nr. 7980, datë 27.7.1995, VKM-ja nr. 428, datë 9.6.2010 dhe Udhëzimi nr.1, datë 22.11.2010 i MF-së dhe METE-së), si trashëgimtarë të ish-pronarit të truallit, z. P.V., sipas vendimit nr. ***, datë 29.10.1993, të Komisionit Kthimit dhe Kompensimit të Pronave të Rrethit Vlorë.

9.6 Vlera e pasurisë është 2.487.400 lekë, e cila përbëhet prej vlerave: (i) 494.805 lekë të paguara nga A.V.; (ii) 1.980.000 lekë bono privatizimi (175.000 lekë bono privatizimi të përfituara nga shteti në vitet e mëparshme: A.V. 75.000 lekë; L.B. 50.000 lekë dhe S.V. 50.000 lekë, ndërsa shuma tjetër prej 1.805.000 lekësh bono privatizimi është blerë në tregun e këmbimit të valutës në vlerën 108.300 lekë nga S.V.); (iii) 13.376 lekë të paguara nga z. S.V.

9.7 ZVRPP-ja Vlorë, konfirmon se pasuria “****” në Spille, Himarë, ka qenë e regjistruar në regjistrin hipotekor nr. ***, datë 5.3.2008, në pronësi të Ministrisë së Mbrojtjes, Komanda e Forcave të Bashkuara, Reparti Ushtarak ***. Kjo pasuri është transkriptuar në regjistrin hipotekor nr. ***, datë 24.9.2013, duke kaluar në pronësi të A.V. të L. (B.) V. dhe të S.V. Më pas, kjo pasuri është ndarë në dy pasuri dhe është transkriptuar në regjistrin hipotekor nr. ***, datë 8.1.2015. Gjithashtu, edhe pasuria e regjistruar në regjistrin hipotekor nr. ***, datë 8.1.2015, është transkriptuar në regjistrin hipotekor nr. ***, datë 27.2.2015, duke kaluar me kontratë dhurimi në pronësi të z. V.V.

9.8 Nga analizimi i burimit të krijimit dhe ligjshmërinë e tij, konstatohet se:

- i. Vlera 494.805 lekë është paguar nga znj. A.V. në datën 17.2.2012 (gjatë vitit 2011, znj A.V., ka përfituar vlerën 884.953 lekë të ardhura nga interesat bankare të depozitave të saj. Gjatë këtij viti ka kryer depozitime në llogaritë bankare me vlerë 711.000 lekë dhe disa tërheqje me vlerë totale 1.292.690 lekë).
- ii. Vlera 1.980.000 lekë në Bono Privatizimi²⁸ - vlera 175.000 lekë bono e përfituar në vitet e mëparshme nga znj. A.V. 75.000 lekë , nga znj. L.B. 50,000 lekë, dhe nga z. S.V. 50,000 dhe 1,805,000 lekë të blera në tregun e valutës me vlerën 108,300 lekë.
- iii. Vlera 13,376 lekë paguar nga z. S.V. në datën 19.3.2013.

Prokurë e posaçme nr. ***, datë 16.9.2014; prokurë e përgjithshme nr. ***, datë 16.9.2009; për emërimin e S.V. si përfaqësues të posaçëm të L.B. që ta përfaqësojë edhe në mungesë të saj pranë: 1. Bankave, “Intesa Sanpaolo Bank”, “ProCredit”, “Raiffeisen Bank”, “Alfa Bank” dhe “BKT” në numrin e llogarisë **** me të drejtën e kompetencën e kryerjes të të gjitha procedurave ligjore që kërkohen për depozitim, tërheqje, thyerje depozitë, transfertë deri edhe në mbyllje të llogarive si dhe transaksion apo operacion bankar në lidhje me emrin e saj. 2. Të gjitha organet administrative shtetërore dhe Agjencive shtetërore apo private, për të ndjekur e tërhequr dokumentacione dhe të tërheqë shuma në lekë apo çdo monedhë tjetër, letra me vlerë apo bono privatizimi që janë në emrin e saj....etj; vërtetim hipoteke, datë 24.1.2011.

²⁷ Shkresa nr. *** prot., datë 23.05.2019; shkresa nr. *** prot., datë 28.05.2019.

²⁸ Referuar mandatit të depozitimit të bonove të privatizimit, datë 9.8.2013, në “Raiffeisen Bank”.

- iv. Me kontratën e dhurimit nr. ***, datë 4.2.2015, është dhuruar pjesa prej 21.5 m² objekt me sipërfaqe funksionale 10.5 m² kushërinjve të bashkëshortit të subjektit V. dhe A.V.

Në lidhje me të ardhurat nga qiraja e kësaj pasurie

9.9 Në lidhje me këtë aset subjekti i rivlerësimit deklaroi në deklaratën “Vetting” të vitit 2017 se ka përfituar të ardhura në shumën 308.333 lekë për periudhën 25.9.2013 – 31.12.2016, dhe personi i lidhur, bashkëshorti i subjektit deklaroi të njëjtën shumë si të ardhura nga qiraja.

9.10 Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë, me shkresën nr. *** prot., datë 17.4.2019, konfirmon se subjekti D.S. person fizik, me NIPT ***, ka deklaruar dhe paguar tatim në burim si më poshtë:

- Viti 2013, deklaruar 0 lekë tatim qiraje.
- Viti 2014, deklaruar 0 lekë tatim qiraje.
- Viti 2015, deklaruar dhe paguar 7.500 lekë tatim qiraje.
- Viti 2016, deklaruar dhe paguar 18.000 lekë tatim qiraje.

Më tej, DRT-ja Vlorë, shpjegon se, nga verifikimi në dosjen elektronike dhe në dosjen fizike të këtij subjekti ka rezultuar se nuk ka të depozituar asnjë kontratë qiraje, për këtë arsye është e pamundur për të konfirmuar nëse tatimi i paguar lidhet me kontratën e qirasë lidhur me shtetasin S.V.

9.11 Nga analizimi i dokumentacionit të administruar nga hetimi administrativ dhe në zbatim të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 84/2016, për ligjshmërinë e të ardhurave, Komisioni konstaton se të ardhurat nga qiraja do të konsiderohen për efekt të analizës financiare vetëm të ardhurat për të cilat është paguar detyrimi tatimor “tatimi në burim nga të ardhurat e qirasë”.

9.12 Komisioni, nga hetimi administrativ kryesisht bazuar në faktet e sipërpërmendura, arriti në rezultatin se:

Në lidhje me pronësinë e asetit: (i) deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe me shkresat e administruara nga hetimi administrativ kryesisht; (ii) ka dokumentacion ligjor justifikues për burimin e krijimit të blerjes së këtij asemi.

9.13 Në lidhje me të ardhurat nga qiraja Komisioni njoftoi subjektin se ka barrën e provës mbi mungesën e dokumentacionit ligjor justifikues në lidhje me vlerën totale të të ardhurave të ligjshme të deklaruara nga subjekti në deklaratën “Vetting”.

9.14 Sipas parashikimeve të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës: *“Subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave. Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore. Elemente të tjera të pasurisë së ligjshme përcaktohen me ligj.”*

9.15 Subjekti i rivlerësimit arriti të shpjegojë bindshëm burimin e krijimit të të ardhurave nga qiraja, por nuk arriti të provojë se këto të ardhura ishin të ligjshme, pasi ato nuk ishin deklaruar dhe për to nuk ishin paguar detyrimet tatimore, pavarësisht se kush e ka përgjegjësinë kontraktuale për të paguar tatimin.

9.16 Komisioni vlerëson se fakti që subjekti i rivlerësimit pagoi detyrimet tatimore për qiratë pas dorëzimit të deklaratës “Vetting”, nuk përbën shkak për njohjen e tyre si të ardhura të ligjshme. Qëllimi i ligjit nr. 84/2016 nuk është mbledhja e taksave dhe tatimeve, por rivlerësimi i pasurisë së subjektit të rivlerësimit bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga subjekti deri në momentin e dorëzimit të deklaratës “Vetting” të vitit 2017.

9.17 Referuar në sa më lart, dokumentacioni i dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit²⁹ për pagesën e tatimit mbi të ardhurat në datën 10.6.2019 nuk merret në konsideratë dhe, për rrjedhojë, këto të ardhura nuk janë të ligjshme.

9.18 Komisioni vlerësoi, gjithashtu, se fakti që këto të ardhura nuk janë përdorur si burim për blerjen e ndonjë pasurie, nuk rezulton të ketë ndikim në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit.

9.19 Në këto kushte, Komisioni, çmon se mungesa e dokumentacionit ligjor justifikues mbi të ardhurat nga qiraja në shumën 308.333 lekë për periudhën 25.9.2013 – 31.12.2016, në pjesë takuese: 33.3 %, nuk përbën shkak për pamjaftueshmëri të deklaramit të pasurisë sipas nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, duke qenë se nuk ka asnjë pasojë negative në analizën financiare të kryer nga Komisioni.

10. Bashkëpronar i apartamentit të banimi me sip. 71.11 m², në Fier

a. Komisioni, për vërtetimin e faktit administroi:

10.1 Deklaratën “Vetting” të vitit 2017 dhe dokumentacionin bashkëlidhur³⁰.

10.2 Provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja dhe nga Komisioni.

10.3 Deklarimet e dhëna me anë të përgjigjeve të pyetjeve të Komisionit dhe dokumentacionit justifikues dërguar me anë të postës elektronike.

b. Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me ligjin e zbatueshëm

10.4 Në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, bashkëshorti i subjektit ka deklaruar se ka në bashkëpronësi me pjesë takuese: 5/48 pjesë, të një apartamenti banimi me sip. 71.11 m², lagja “****”, p. ***, sh. ***, k. ***, ap. ***, Fier.

10.5 Si burim krijimi bashkëshorti i subjektit ka deklaruar ligjin për privatizimin e banesave shtetërore dhe me trashëgiminë me nr. pasurie ***, z.k. ***, Fier. Vlera e blerjes sipas kontratës së privatizimit: 12.751 lekë. Vlera aktuale: 3.185.280 lekë. Pjesa takuese: 5/48 pjesë.

10.6 Nga hetimi i kryer, konfirmohet se shtetasi S.E.V., i datëlindjes 28.10.1976, figuron të ketë të regjistruar pasuri të paluajtshme në ZVRPP-në Fier, pasurinë apartament me sip. 71.11 m², me certifikatë pronësie datë 8.11.2013 (këtë pasuri e disponon në bashkëpronësi me shtetasit A.T.V., L.E.V. dhe Gj.S.V.). Ky apartament është përfituar nga ligji për privatizimin nr. ***, datë 23.12.1992. Nga dokumentacioni i administruar, personi i lidhur/bashkëshorti i subjektit ka ¼ pjesë takuese.

Në lidhje me të ardhurat nga qiraja e këtij aseti

10.7 Në lidhje me këtë aset, subjekti i rivlerësimit deklaroi në deklaratën “Vetting” të vitit 2017 se ka përfituar të ardhura në shumën 36.000 lekë për vitet 2014, 2015, 2016 dhe personi i lidhur, bashkëshorti i subjektit, deklaroi po të njëjtën shumë si të ardhura nga qiraja.

10.8 Në deklaratën periodike vjetore për vitin 2014, dhe deklaratën “Vetting”, personi i lidhur/bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka deklaruar se për vitin 2014 kontrata e qirasë në vlerën 20.000 lekë, si pjesë takuese e tij, është lidhur gojarisht nga bashkëpronarja A.V. për vlerën 120.000 lekë dhe këto të ardhura janë marrë *cash*.

²⁹ Kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 30.01.2017, nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Vlorë; urdhërpagesë për tatimin mbi të ardhurat individuale; mandate derdhjeje për segmentin e taksave, datë 10.9.2019, në “Raiffeisen Bank”.

³⁰ Shkresë datë 27.10.2016, nga ZVRPP-ja Fier; certifikatë pronësie nr. ***; kontratë qiraje nr. ***, datë 30.7.2015.

10.9 Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, me shkresën nr. *** prot., datë 17.04.2019, konfirmon se:

- i. për vitin 2015, subjekti “***” sh.p.k., ka llogaritur qira në shumën 3.166.393 lekë, ka paguar dhe ka deklaruar tatim qiraje në shumën 474.959 lekë;
- ii. për vitin 2015, subjekti “***” sh.p.k., ka llogaritur qira në shumën 6.171.500 lekë, ka paguar dhe ka deklaruar tatim qiraje në shumën 925.725 lekë.

10.10 PAGESA E TATIMIT NË BURIM PËR QIRANË ËSHTË BËRË NË TOTALIN E PAGESAVE TË TATIMIT NË BURIM DHE KONTRATA NR. ***, DATË 30.7.2015, ËSHTË DEKLARUAR NË SISTEMIN C@TS.

10.11 Nga analizimi i dokumentacionit të administruar nga hetimi administrativ dhe në zbatim të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, për ligjshmërinë e të ardhurave, Komisioni konstaton se të ardhurat nga qiraja do të konsiderohen për efekt të analizës financiare vetëm të ardhurat për të cilat është paguar detyrimi tatimor “tatimi në burim nga të ardhurat e qirasë”.

10.12 Komisioni nga hetimi administrativ kryesisht bazuar në faktet e sipërpërmendura, arriti në rezultatin se: në lidhje me pronësinë e asetit: (i) deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe shkresat e administruara nga hetimi administrativ kryesisht; (ii) ka dokumentacion ligjor justifikues për burimin e krijimit të blerjes së këtij aseti.

10.13 Në lidhje me të ardhurat nga qiraja, Komisioni njoftoi subjektin se ka barrën e provës mbi mungesën të dokumentacionit ligjor justifikues në lidhje me vlerën totale të të ardhurave të ligjshme të deklaruara nga subjekti në deklaratën “Vetting”.

10.14 Sipas parashikimeve të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës: *“Subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave. Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore. Elemente të tjera të pasurisë së ligjshme përcaktohen me ligj.”*

10.15 Subjekti i rivlerësimit arriti të shpjegojë bindshëm burimin e krijimit të të ardhurave nga qiraja, por nuk arriti të provojë se këto të ardhura ishin të ligjshme, pasi ato nuk ishin deklaruar dhe për to nuk ishin paguar detyrimet tatimore, pavarësisht se kush e ka përgjegjësinë kontraktuale për të paguar tatimin.

10.16 Komisioni vlerëson se fakti që subjekti i rivlerësimit pagoi detyrimet tatimore për qiratë pas dorëzimit të deklaratës “Vetting”, nuk përbën shkak për njohjen e tyre si të ardhura të ligjshme. Qëllimi i ligjit nr. 84/2016, nuk është mbledhja e taksave dhe tatimeve, por rivlerësimi i pasurisë së subjektit të rivlerësimit, bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga subjekti deri në momentin e dorëzimit të deklaratës “Vetting” të vitit 2017.

10.17 Referuar në sa më lart, dokumentacioni i dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit³¹ për pagesën e tatimit mbi të ardhurat në datën 10.6. 2019, nuk merret në konsideratë dhe për rrjedhojë këto të ardhura nuk janë të ligjshme.

10.18 Komisioni vlerësoi, gjithashtu, se fakti që këto të ardhura nuk janë përdorur si burim për blerjen e ndonjë pasurie, nuk rezulton të ketë ndikim në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit.

10.19 Në këto kushte, Komisioni çmon se mungesa e dokumentacionit ligjor justifikues mbi të ardhurat nga qiraja, nuk përbën shkak për pamjaftueshmëri të deklarimit të pasurisë sipas

³¹ Kthim përgjigjeje, nr. *** prot., datë 30.01.2017, nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Vlorë; urdhërpagesë për tatimin mbi të ardhurat individuale për periudhën janar – dhjetor 2014; mandate derdhjeje për segmentin e taksave në “Raiffeisen Bank”;

nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, duke qenë se nuk ka asnjë pasojë negative në analizën financiare të kryer nga Komisioni.

11. Në lidhje me depozitën bankare të krijuar në datën 8.10.2013 në “Veneto Bank” për vlerën 2.100.000 lekë, në emër të personit të lidhur/bashkëshortit të subjektit dhe depozitën bankare në “Credins Bank”, e krijuar në datën 20.2.2015, në vlerën 18.500 USD + 295 USD interesa.

a. Komisioni, për vërtetimin e faktit, administroi:

11.1 Deklaratën “Vetting” të vitit 2017 dhe dokumentacionin bashkëlidhur³²

11.2 Dokumentacionin e administruar nga të gjitha bankat e niveli te dytë³³.

11.3 Deklarimet e dhëna me anë të përgjigjeve të pyetjeve të Komisionit dhe dokumentacionin justifikues të dërguar me anë të postës elektronike.

b. Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me ligjin e zbatueshëm

11.4 Në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, bashkëshorti i subjektit i rivlerësimit ka deklaruar: (i) depozitë bankare në “Veneto Bank”, e krijuar në datën 8.10.2013, me vlerën 2.100.000 lekë, me kontratë nr. ***, datë 17.10.2016. Kjo shumë është kaluar nga nr. i llogarisë i së motrës së tij, L.B.(V.), nga “Raiffeisen Bank”, për të cilën personi i lidhur/bashkëshorti i subjektit është përfaqësues i saj i autorizuar dhe me prokurë. Pjesa takuese: 100%; (ii) depozitë bankare në “Credins Bank”, e krijuar në datën 20.2.2015, në vlerën 18.500 USD + 295 USD interes, pjesa takuese: 100 %.

11.5 Bashkëshorti i subjektit ka deklaruar si burim krijimi të këtyre depozitave shumë e të hollave të përfituar nga nëna e tij A.V., për shkak shpronësimi sipas vendimit nr. 855, datë 13.12.2006 i Këshillit të Ministrave, i ndryshuar me vendimin nr. ***, datë 18.7.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. (Shpjegimi i hollësishëm gjendet te pjesa konfidenciale.)

11.6 Nga hetimi administrativ kryesisht u administrua dokumentacioni nga “Intesa Sanpaolo Bank” (administratori i arkivit të “Veneto Bank”)³⁴, i cili konfirmon llogarinë në emër të personit të lidhur/shtetasit S.V. me gjendje llogarie në vlerën 2.100.000 lekë, në datën 30.1.2017, dhe nga “Credins Bank”³⁵ konfirmohet llogaria në emër të personit të lidhur/shtetasit S.V. me gjendje llogarie në vlerën 18.751 USD, në datën 30.1.2017.

³² Kontratë depozite, datë 17.10.2016, nga “Veneto Bank”, depozituesi S.V. depoziton shumë 2.100.000 lekë; printim i llogarisë nr. *** në lekë nga “Veneto Bank”; në datën 8.10.2013 kemi veprimin xhirim fondesh nga S.V. të shumës 2.100.000 lekë; në datën 15.10.2015 kemi kalim fondesh (shuma 2.100.000 lekë) nga S.V. për çelje të një depozite të re; në datën 17.2.2015 kemi tërheqje *cash* nga llogaria të shumës 103.950 lekë dhe tërheqje interesash datë 15.10.2015, në shumë 45.423 lekë. Gjendja e llogarisë në datën 27.1.2017 është 0.00 lekë; printim i llogarisë nr. *** në lekë nga “Veneto Bank”; në datën 7.10.2013 kemi transfertë L.B. të shumës 2.100.000 lekë dhe në datën 8.10.2013 kemi xhirim fondesh të shumës 2.100.000 lekë nga S.V.; në datën 10.10.2014 kemi veprim kredie (shuma 1.956 lekë) nga S.V. Gjendja e llogarisë në datën 27.1.2017 është 0.00 lekë; “printim i llogarisë *** në lekë nga “Veneto Bank”, të shtetasit S.V.; në datën 15.10.2015 kemi kalim fondesh për çelje depozite nga S.V. të shumës 2.100.000 lekë. Tërheqje *cash* nga llogaria datë 17.10.2016 të shumës 44.625 lekë. Gjendja e llogarisë në datën 27.1.2017 është 2.100.000 lekë; nxjerrje llogarie nga “Raiffeisen Bank” për shtetasen L.B.; në datën 8.9.2009 kemi kalim në llogari të L.B. të shumës 2.100.000 lekë dhe po në këtë datë kjo shumë ka kaluar në depozitë në emër të L.B.; në datat 23.9.2010, 3.10.2011, 3.10.2012 dhe 29.5.2014 kemi tërheqje nga kjo llogari nga S.V. të shumave 113.000 lekë, 104.900 lekë, 109.900 lekë dhe 84.499 lekë; në datën 4.10.2013 kemi transferimin e shumës 2.100.000 lekë në llogarinë e S.V.; njoftim debitimi, datë 4.10.2013, nga “Raiffeisen Bank”; vendimi nr. ***, datë 18.7.2007, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës; aktmarrëveshje datë 11.4.2007.

³³Kërkesë, nr. ***, datë 17.01.2019, drejtuar të gjitha bankave të nivelit të dytë.

³⁴ Shkresën nr. *** prot., datë 2.1.2019, nga “Intesa Sanpaolo Bank”.

³⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 26.2.2019.

11.7 Në deklaratën e interesave privatë periodikë vjetorë të vitit 2013, personi i lidhur/S.V. ka deklaruar depozitë në “Veneto Bank”, krijuar në datën 8.10.2013, në vlerën 2.100.000 lekë. Kjo shumë ka kaluar nga numri i llogarisë i së motrës, L.B. (V.), nga “Raiffeisen Bank”, si përfaqësues i autorizuar me prokurë.

11.8 Në deklaratën e interesave privatë periodikë vjetorë 2015, personi i lidhur/S.V. ka deklaruar depozitë në “Credins Bank”, krijuar në vitin 2015, në vlerën 18.500 USD. Këtë shumë personi i lidhur/S.V. e ka tërhequr nga numri i llogarisë i së motrës, L.B. (V.), nga “Intesa Sanpaolo Bank”, si përfaqësues i autorizuar me prokurë.

11.9 Në lidhje me deklaratimet, Komisioni arrin në përfundimin se personi i lidhur me subjektin ka deklaruar saktë në deklaratën “Vetting” 2017 llogaritë bankare në emër të tij.

Në lidhje me burimin e krijimit të këtyre depozitave

11.10 Nga hetimi administrativ kryesisht u provua se këto depozita/llogari bankare kishin si burim krijimi të ardhurat e përfituara nga personit tjetër i lidhur/znj. A.V. me vendimin nr. 855, datë 13.12.2006, të Këshillit të Ministrave, për një sip. 3703 m², për shumën 11.190.000 lekë, ndryshuar me vendim të Gjykatës së Apelit Durrës në shumën përfundimtare **28.929.687,5 lekë**.

11.11 Në lidhje me transferimin e kësaj shume të përfituar, nga informacioni i administruar nga “Intesa Sanpaolo Bank”³⁶, konstatohet se pjesë e kësaj shume, pikërisht vlera prej 9.643.229 lekësh është transferuar në llogari të znj. A.V. në datën 29.5.2008 dhe nga informacioni i dhënë nga “ProCredit Bank”³⁷ konstatohet se në datën 1.6.2009 është transferuar diferenca e mbetur në shumën 19.286.458 lekësh në llogari të znj. A.V. Pra, konfirmohet se shuma e sipërpërmendur e përftuar me anë të vendimit të Gjykatës së Apelit Durrës, respektivisht 28.929.687,5 lekë, përfituar nga personit tjetër i lidhur znj. A.V., është kaluar nga Autoriteti Portual Durrës (si autoriteti publik shpronësues) te znj. A.V., në dy transferta përshkruar si më lart.

11.12 Në datën 4.6.2009 personi tjetër i lidhur/A.V. nga llogaria e nga shuma prej 19.286.458 lekësh në “Pro Credit Bank” (shumë e transferuar nga shpronësimi), i ka transferuar personit të lidhur/bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit shumën prej 13.686.000 lekësh, me përshkrimin “A.V., kalim nga vlera e shpronësimit për S.V.”

11.13 Me transferimin e kësaj shume, personi i lidhur/bashkëshorti i subjektit nga data 4.6.2009 deri më 9.9.2009, ka kryer debitime me llogaritë e tij në “ProCredit Bank”, duke përfituar dhe interesa bankare.

11.14 Personi i lidhur/bashkëshorti i subjektit këtë shumë e transferon nga llogaritë e tij, tek llogaritë e së motrës/L.V. dhe kjo e fundit në datën 16.9.2009 lëshon prokurën e përgjithshme nr. ***, në emër personit të lidhur/S.V. Në këtë prokurë parashikohet se përfaqësuesi ka të drejtë ta përfaqësojë atë te bankat, me të drejtën dhe kompetencën e kryerjes së të gjitha procedurave ligjore që kërkohen për depozitim, tërheqje, thyerje depozite, transfertë, deri edhe në mbyllje të llogarive, si dhe për transaksione apo operacione bankare në emër të saj, si dhe në të gjitha organet administrative shtetërore dhe agjencitë shtetërore apo private, për të ndjekur dhe për të tërhequr dokumentacione, shuma në lekë apo në çdo monedhë tjetër, letra me vlerë apo bono privatizimi që janë në emrin e saj.

³⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 11.4.2019, nga “Intesa Sanpaolo Bank”.

³⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 25.1.2019, nga “ProCredit Bank”.

11.15 Më tej, personi i lidhur/z. S.V., e transferon në bazë të prokurës që zotëronte si më lart, nga llogaria e motrës së tij, L.B., në llogarinë e tij në “Veneto Bank”, vlerën prej 2.100.000 lekësh dhe krijon llogarinë që ai ka deklaruar në deklaratën “Vetting” 2017.

11.16 Ndërkohë që llogarinë tjetër prej 18.500 USD e krijon nga tërheqja e shumës prej 2.299.000 lekësh nga llogaria e së motrës, L.B., në “Intesa Sanpaolo Bank”.

11.17 Në lidhje me krijimin e këtyre llogarive, transferimet, tërheqjet dhe depozitimet nga ana e personit tjetër të lidhur, Komisioni vlerëson se ai ka qenë administrues i këtyre shumave të përfituara nga shpronësimi për interes publik, vërtetuar përmes deklaratës noteriale të lëshuar nga nëna e tij, znj. A.V., si dhe deklarimit të tij në deklaratën “Vetting”.

11.18 Në lidhje me ligjshmërinë e burimit të krijimit të këtyre të ardhurave, **Komisioni arrin në përfundimin** se të ardhurat për krijimin e këtyre dy llogarive janë nga burime plotësisht të ligjshme.

12. Dëshmipërblim për vitet e burgut të të ndjerit, z. E.S.V.

a. Komisioni, për vërtetimin e faktit, administroi:

12.1 Deklaratën “Vetting” të vitit 2017 dhe dokumentacionin bashkëlidhur³⁸.

12.2 Provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja dhe Komisioni.

12.3 Shkresën nga “Raiffeisen Bank”.

b. Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me ligjin e zbatueshëm.

12.4 Në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, bashkëshorti i subjektit i rivlerësimit ka deklaruar se ka përfutuar dëshmipërblim për vitet e burgut nga i ndjeri babai i tij, E.S.V., në shumën 260.466 lekë.

12.5 Si burim krijimi bashkëshorti i subjektit deklaroi se ka shërbyer vendimi nr. 707, datë 23.6.2009, i Këshillit të Ministrave, i ndryshuar me vendimin nr. 839, datë 21.10.2010, të Këshillit të Ministrave.

12.6 Nga hetimi administrativ kryesisht, u konstatua se, sipas lëvizjeve të llogarive bankare të përcjella nga “Raiffeisen Bank” me shkresën nr. *** prot., datë 23.1.2019, konstatohet se në llogarinë bankare të z. S.V., nr. ***, janë transferuar shumat e mëposhtme:

- datë 4.8.2010, vlera 267.406 lekë;
- datë 24.12.2010, vlera 123.293 lekë;
- datë 15.05.2013, vlera 390.700 lekë.

12.7 Në deklaratën periodike vjetore për vitet 2010 dhe 2013, personi i lidhur/z. S.V. ka deklaruar përfitimin e këtyre shumave.

12.8 Komisioni, pasi shqyrtoi dhe analizoi provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit dhe ato të administruara gjatë hetimit, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka bërë

³⁸ Shkresa nr. *** prot, datë 7.12.2016, e Ministrisë së Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, nëpërmjet të cilës konfirmon dosja e ish të përndjekurit politik E.V., me nr. ***, VKM 707, ka përfutuar dy këste takuese të dëshmipërblimit financiar, ndërkohë që ende nuk është çelur kësti i tretë për këtë kategori. S.V. ka përfutuar: Këstin e parë në shumën 130.233 lekë (në datat 25.6.2010, 17.11.2010) dhe këstin e dytë në shumën 130.233 lekë (në datën 29.4.2013); shkresa nr. *** prot, datë 17.1.2017, e Ministrisë së Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, nëpërmjet të cilës konfirmohet se vlera e dëshmipërblimit financiar për ish të dënuarit politik E.V. është miratuar me VKM nr. 707, datë 23.6.2009, në vlerën 3.125.600 lekë. Ministria e Financave ka kryer shpërndarjen e këstit të parë dhe të dytë për trashëgimtarët e E.V. (S.V., A.V. dhe L.B.), Këstin e parë në shumën totale 390.699 lekë dhe këstin e dytë në shumën totale 390.699 lekë. (gjithsej të dy këstet 781.398 lekë). Në bazë të ligjit, trashëgimtarët i kanë deleguar tërheqjen e dëshmipërblimit financiar S.V. me prokurën nr. ***, datë 16.9.2009, për L.B. dhe prokurën nr. ***, datë 6.6.2009, për A.V.

deklarim të saktë dhe në përputhje me ligjin, si dhe ka burime financiare me dokumentacion justifikues ligjor për burimin e krijimit të këtyre të ardhurave të deklaruara.

13. Shuma e dhënë hua nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit nënës së tij, A.V., rreth muajve dhjetor 2004 – janar 2005. Vlera: 400.000 lekë

a. Komisioni, për vërtetimin e faktit, administroi:

13.1 Deklaratën “Vetting” të vitit 2017 dhe dokumentacionin bashkëlidhur

13.2 Provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja dhe Komisioni.

13.3 Provat shkresore nga institucionet publike dhe private, të administruara nga Komisioni në dosje.

b. Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me ligjin e zbatueshëm

13.4 Në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, bashkëshorti i subjektit ka deklaruar: pjesërisht transferuar nëpërmjet “Tirana Bank” në datën 6.12.2004, shuma 204.946 lekë dhe pjesa tjetër 195.054 lekë dhënë *cash*.

13.5 Si burim krijimi bashkëshorti i subjekti deklaroi se kanë shërbyer kursimet nga punësimi.

13.6 Nga hetimi administrativ kryesisht, u konstatua se bazuar në dokumentacion ligjor të administruar, vërtetimet nga institucionet publike dhe private për të ardhurat e personit të lidhur/bashkëshortit të subjektit deri më 31.12.2004, pa përfshirë të ardhurat nga pagat nga “****”, janë 387.036 lekë.

13.7 Komisioni, nga hetimi administrativ kryesisht bazuar në faktet e sipërpërmendura, arrin në rezultatin se mungon dokumentacioni ligjor justifikues për pagesat e kryera ndaj personit të lidhur/bashkëshortit të subjektit, dhe mundësisë së tij për t’i dhënë hua znj. A.V.

13.8 Bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D, të Aneksit të Kushtetutës, subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

13.9 Subjekti, në prapësimet e saj, ka paraqitur si provë vërtetimin³⁹ e shoqërisë “****” sh.a., e cila administron pjesërisht dokumentacionin e shoqërisë “****” sh.a. dhe konkretisht degës së shpërndarjes së karburanteve, e cila ka bërë dhe shlyerjen e pagave, ku evidentohet pagesa e bërë nga kjo shoqëri në favor të bashkëshortit të saj për periudhën 17 mars 2003 – 17 mars 2004.

13.10 Situata pas dorëzimit të vërtetimit nga shoqëria “****” sh.a.

Përshkrimi	Vlera
Të ardhura nga pagat, periudha 20.12.1999 – 31.12.2004	931,436
Shpenzime jetese, periudha 20.12.1999 – 31.12.2004	518,295
Huaja e dhënë	400,000
Gjendje likuiditete në bankë, datë 31.12.2004	127,106
Balanca e fondeve (Të ardhura – shpenzime – huaja – likuiditete)	- 113,965

³⁹ Vërtetim nga Drejtorja e Arkivit Qendror, Dega e Arkivit të Rajonit Tiranë, për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare për periudhën korrik 2002 – mars 2003; vërtetim nga shoqëria “****” sh.a., Arkivi “****” sh.a., për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare nga 17.03.2003 – 17.03.2004; njoftim për zgjidhjen e kontratës së punës nga drejtorja e shoqërisë “****”.

13.11 Mbeten të pakonfirmuara 128.576 lekë, paga nga “***” sh.a. për periudhën shtator – dhjetor 2002, për të cilën Arkivi Lundër ka shënuar “jo në listë”. Por periudha e mësipërme është shënuar si periudhë punësimi në librezën e punës së bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit.

13.12 Duke qenë se kjo periudhë punësimi është e shënuar në librezën e punës së bashkëshortit të subjektit dhe punësimi për periudhën 17 mars 2003 – 17 mars 2004, u vërtetua me vërtetimin e shoqërisë “***” sh.a., konfirmohet periudha e punësimit pranë kësaj shoqërie dhe, rrjedhimisht, të ardhurat e përftuara nga paga.

13.13 Komisioni, pasi shqyrtoi dhe analizoi provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit dhe ato të administruara gjatë hetimit, çmon se duken bindëse dhe të bazuara në prova shpjegimet e subjektit të rivlerësimit.

14. Hua e marrë nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, z. S.V., nga z. Gj.B. dhe znj. L.B., përkatësisht, kunati dhe motra e tij në datën 19.9.2012, pa afat, në shumën 2.000 euro

a. Komisioni, për vërtetimin e faktit, administroi:

14.1 Deklaratën “Vetting” të vitit 2017 dhe dokumentacionin bashkëlidhur.

14.2 Provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja dhe Komisioni.

14.3 Provat shkresore në dosje nga institucionet publike dhe private, të administruara nga Komisioni.

b. Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me ligjin e zbatueshëm

14.4 Në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka deklaruar se ka marrë një hua nga shtetasit Gj.B. dhe L.B., përkatësisht kunati dhe motra e tij, në datën 19.9.2012 në shumën 2.000 euro, , pa afat, si dhe detyrimin e mbetur në deklaratat e interesave privatë ndër vite.

14.5 Si burim krijimi personi i lidhur/bashkëshorti i subjektit ka deklaruar interesat bankare nga depozitat në emër të znj. L.B.

14.6 Nga hetimi administrativ kryesisht, u konstatua se subjekti ka dorëzuar lëvizjet e llogarive bankare të znj. L.B.V. (lëvizje llogarie “Raiffeisen Bank”, 14.1.2005 – 9.1.2017; lëvizje llogarie në “Alpha Bank”, 9.9.2009 – 28.10.2016; lëvizje llogarie “BKT”, 1.9.2009 – 6.1.2017; lëvizje llogarie “Pro Credit”, 1.12.2010 – 22.10.2016; lëvizje llogarie “Tirana Bank”, 1.1.2009 – 10.1.2017; lëvizje llogarie “Intesa Sanpaolo Bank”, 1.1.2009 – 28.10.2016), ku vërehet se tërheqjet e interesave të fituara nga depozitat tërhiqen rregullisht nga z. S.V., por nuk ka evidencë të destinacionit të këtyre tërheqjeve.

14.7 Gjatë hetimit, u konstatuan tri tërheqje të kryera nga z. S.V. nga llogaritë bankare të znj. L.V.: “BKT”, datë 10.9.2012, vlera 127,750 lekë; “Procredit Bank”, datë 10.9.2012, vlera 117,000 lekë; “Tirana Bank”, datë 13.9.2012, vlera: 120.790 lekë, me shumë totale 365.540 lekë.

14.8 Sipas lëvizjeve të llogarive bankare të përcjella nga “Tirana Bank” me shkresën nr. *** prot., datë 4.2.2019, në llogarinë me numër ***, në emër të z. S.V., konstatohet një transfertë në mbërritje me vlerë 1.995 euro në datën 19.9.2012, me koment “***”. Komisionet bankare të mbajtura nga transfertat në mbërritje janë në shumën 3 euro.

14.9 Në pyetësorin e muajit prill 2019 subjekti i rivlerësimit është pyetur për arsyen e marrjes së kësaj huaje. Subjekti i rivlerësimit shpjegoi se këtë shumë bashkëshorti i saj e ka marrë nga

znj. L.B. dhe z. Gj.B. për nevoja jetese, duke qenë se në atë periudhë subjekti i rivlerësimit ka qenë me leje barrë lindjeje dhe numri i pjesëtarëve në familjen e saj ishte shtuar. Kjo hua ishte kthyer në vitin 2017.

14.10 Për të theksuar mundësitë financiare të znj. L. dhe z. Gj.B., subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar edhe dokumentacion ligjor justifikues për të ardhurat e realizuara nga punësimi në Itali i znj. L.B. dhe z. Gj.B.

14.12 Komisioni, pasi shqyrtoi dhe analizoi provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit dhe ato të administruara gjatë hetimit, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të saktë dhe në përputhje me ligjin, si dhe ka burime financiare me dokumentacion justifikues ligjor lidhur me këtë hua.

KONSTATIME TË TJERA TË DALA GJATË HETIMIT ADMINISTRATIV

15. Likuiditete në bankë të personit tjetër të lidhur/znj. A.V.

a. Likuiditeti për periudhën 2004 – 2007

15.1 Nga dokumentacioni i administruar nga të gjitha bankat gjatë hetimit, u konstatua se në fund të vitit 2007, personi tjetër i lidhur/zonja A.V., ka gjendje likuiditeti në bankë në shumën 2.169.211 lekë.

15.2 Nga analizimi i llogarive bankare të znj. A.V. për periudhën 2004 – 2007, konstatohet se gjendja e llogarive të znj. A.V. në fund të vitit 2007 është 2.169.211 lekë (1.531.993 lekë dhe 5.151,20 euro), në “Tirana Bank”, “Intesa Sanpaolo” dhe “Raiffeisen Bank”.

15.3 Subjekti i rivlerësimit i është kërkuar të paraqesë dokumentacion ligjor justifikues për burimin e krijimit të kësaj shume nga znj. A.V. Subjekti i rivlerësimit shpjegoi se ajo dhe bashkëshorti i saj nuk kanë pasur dijeni, duke qenë se është një llogari bankare personale në emër të znj. A.V., e cila i ka vënë në dijeni se janë depozita të krijuara prej saj me kursime nga pagat, pensionet e grumbulluara, pasi është rezidente në Itali, ku ka përfshirë edhe para nga huaja e marrë e z. S.V. dhe ndihma në të holla nga vajza e saj, L.B.V., me të ardhura e siguruar nga kjo e fundit nga puna e saj në Shqipëri dhe më pas në Itali. Për të provuar dëshmitë e saj subjekti i rivlerësimit dorëzoi dokumentacion ligjor provues ⁴⁰.

15.4 Nuk mund të përcaktohet sa ka qenë kontributi i zonjës L.B. (V.), pasi nuk ka një akt të shkruar ku të jetë evidentuar ky kontribut në këtë marrëdhënie të ngushtë familjare, duke pasur parasysh se znj. A.V. është në përbërje familjare me znj. L.B. (V.) dhe z. Gj.B.

15.5 Në faqen zyrtare *online* të ISTAT Italia nuk ka informacion për minimumin jetik për periudhën 1999 – 2004. Konstatohet që gjatë periudhës 2005 – 2006, të ardhurat e znj. L.B. dhe z. Gj.B. janë dukshëm më të larta se minimumi jetik.

15.6 Të ardhurat e znj. A.V. gjatë viteve 2004 – 2006 nga pensionet dhe huaja prej 400.000 lekësh nga S.V., janë në shumën 1.061.013 lekë, ndërsa shtimi i llogarive bankare gjatë periudhës 2004 – 2006 është në shumën 1.391.518 lekë, duke rezultuar një mungesë prej –

⁴⁰ Certifikatë familjare dhe e rezidencës, datë 11.11.2015, lëshuar Citta di Rivalaro Canavese, subjekti i rivlerësimit e dorëzoi këtë dokument me vulë apostile sipas formës së kërkuar nga ligji, në datë 15.06.2019; vërtetim nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Fier për të ardhurat nga përfitimi i pensionit të pleqërisë nga janari 2003 e në vazhdim, si dhe fotokopja e dosjes së pensionit me nr. *** e cila ndodhet në arkivin e DRSH-së Fier; ekstrakte elektronike të të ardhurave *bruto* të L.V. në Itali për periudhën 1999 – 2006 dhe të të ardhurave *bruto* të Gj.B. për periudhën 1999–2019, subjekti i rivlerësimit në datën 15.6.2019, dorëzoi këtë dokument me vulë apostile sipas formës së kërkuar nga ligji.

330,505 lekësh. Nuk janë përllogaritur shpenzime jetese për shkak se znj. A.V. ka qenë rezidente në Itali dhe ka jetuar në familjen e vajzës së saj, znj. L.B. (V.).

15.7 Komisioni arriti në konkluzionin se, bazuar në faktet e sipërpërmendura, duke konsideruar të ardhurat e krijuara në shtetin italian të znj. L.B. dhe z. Gj.B., rezulton se ata kanë pasur mundësi financiare të ndihmojnë shtetasen A.V. me vlerën 330.505 lekë, duke justifikuar kështu rritjen e gjendjes së llogarive të saj bankare gjatë periudhës 2004 – 2007.

b. Likuiditeti për periudhën 2008 – 2018

15.10 Për sa i përket gjendjes së llogarive bankare të shtetasen A.V. për periudhën 2008 – 2018, u krye verifikimi dhe analiza e tyre bazuar në dokumentacionin e administruar nga bankat.

15.10 Komisioni arriti në konkluzionin se gjendja totale e likuiditeteve (duke përfshirë edhe investimin në bono thesari) në datën 31.12.2018 është vlerë e akumuluar nga të ardhurat të ligjshme (shuma e shpronësimit e përfituar nga Autoriteti Portual Durrës, pensionet dhe interesat bankare të depozitave).

16. Kontrolli i deklarimeve vjetore të interesave privatë në ILDKPKI

16.1 Nga kontrolli i deklaramit të interesave privatë gjatë viteve, komisioni konstatoi se subjekti i rivlerësimit: (i) nuk ka deklaruar në deklaratën “Vetting” llogaritë bankare në emër të të birit, E.S.V., llogaritë në lekë në shumë 5.000 lekë, sipas transfertës nga Njësia Bashkiake Nr. ***, me koment “Pagesat e fëmijëve” në datën 2.4.2015 dhe gjendje e llogarisë 5.000 lekë, llogari shpërblimi si bebe e porsalindur.

16.1 Subjektit iu kërkua të japë shpjegime për sa rezultoi gjatë hetimit. Ajo deklaroi se: *“Për sa i përket llogarive bankare në lekë të hapura në emër të djalit tim, E.S.V., në “Credins Bank” sipas transfertës nga Njësia Bashkiake nr. ***, me koment “Pagesat e fëmijëve” në datën 2.4.2015 dhe në “Abi Bank”, llogari shpërblimi si bebe e porsalindur nuk jam vënë në dijeni të këtyre llogarive bankare të hapura për shkak të fëmijëve të porsalindur si nga Njësia Bashkiake, ashtu dhe nga “Abi Bank”, në emër të djalit tim, duke mos u vënë në dijeni të këtyre llogarive ,dhe nuk më është vënë në dukje as nga ILDKPKI-ja. Siç rezulton dhe nga informacioni i marrë nga ana juaj mosqenia ime në dijeni provohet dhe nga fakti që në këtë numër llogarie as nga unë dhe as nga bashkëshorti im nuk është kryer asnjë veprim.”*

16.2 Në përfundim, Komisioni çmon se shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit duken bindëse dhe konsiderohen si pasaktësi gjatë deklaramit ndër vite, por jo në deklaratën “Vetting”, pasi nuk janë përdorur si burim për ndonjë nga pasuritë e subjekti të rivlerësimit.

16.3 Gjithashtu nga hetimi i Komisionit, rezultoi se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit: (i) nuk ka plotësuar deklaratën e interesave privatë periodike si person i lidhur për vitin 2005; *certifikata e martesës mban datën 5.6.2005;* (ii) deklarimi i depozitës së krijuar në “Tirana Bank” në vitin 2004 është bërë në deklaratën periodike të vitit 2007. Bashkëshorti i subjektit nuk ka dhënë shpjegime për burimin e krijimit; (iii) deklarimi i huas prej 400.000 lekësh dhënë nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit nënës së tij është bërë në vitin 2007. Sipas deklaramit në deklaratën “Vetting” kjo hua është dhënë rreth muajve dhjetor 2004 – janar 2005; (v) në deklaratën periodike të vitit 2009 bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka deklaruar blerjen e një automjeti tip “Fiat”, me vlerë 120.000 lekë, por nuk ka shpjeguar burimin e krijimit.

16.4 Subjektit iu kërkua të japë shpjegime për sa rezultoi gjatë hetimit. Ajo deklaroi se bashkëshorti i saj ka bërë deklarim në vitin 2005, duke qenë se ishte subjekt deklarimi më vete, i punësuar pranë Ministrisë së Financave si nëpunës civil në Sektorin e Prokurimeve në

Drejtorinë e Legjislacionit në Ministrinë e Financave (për dy vjet). Deklarimi i pasurisë së bashkëshortit të saj nuk është bërë për herë të parë në vitin 2007, por pasuritë e tij janë rideklaruar për herë të parë në deklaratën e saj në vitin 2007. Në lidhje me automjetin tip “Fiat” subjekti sqaroi se si burim i krijimit kanë shërbyer të ardhurat nga depozita e bashkëshortit në shumën 100.000 lekë në “Tirana Bank”, së bashku me interesat, totali 122.000 lekë, gjendje në këtë bankë dhe është tërhequr gjatë vitit 2008 për blerjen e këtij automjeti në vitin 2009.⁴¹

16.5 Lidhur me faktin se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar ndër vite gjendjen e llogarisë së pagës në “Raiffeisen Bank”, gjendja e llogarive të kursimit në “ProCredit Bank” është deklaruar vetëm për vitin 2005 dhe nuk është deklaruar gjendja e llogarive për vitin 2006 dhe 2007 (në datën 31.12.2006 vlera ka qenë 5.217 lekë dhe në datën 31.12.2007 ka qenë 10.509 lekë), si dhe faktit se bashkëshorti i saj nuk ka deklaruar ndër vite gjendjen e llogarive të pagës në “Raiffeisen Bank”, “Intesa Sanpaolo Bank”, “Tirana Bank”, shpjegoi se duke bërë deklarin e të ardhurave nga pagat në këto llogari e kishte quajtur të përmbushur detyrimin ligjor të deklarimit nga ana e saj dhe e bashkëshortit. Në lidhje me gjendjen në “ProCredit Bank” për vitet 2006 dhe 2007, subjekti sqaroi se kjo llogari ishte tërhequr gjatë vitit 2016, duke mbetur një vlerë e papërfillshme.

16.6 Komisioni, analizon se në referim të pikës 3 të nenit 7, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, *“Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”*, citohet se: *“Të gjithë zyrtarët dhe personat e tjerë të lidhur, që mbartin detyrim për deklarin, detyrohen të paraqesin deklaratën e tyre deri më 31 mars të çdo viti, pranë autoritetit ose strukturës përgjegjëse të institucionit publik, të parashikuar në germen “b”, të pikës 2, të nenit 41, të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005”*.

16.7 Në përfundim, Komisioni çmon se mospasqyrimi i këtyre të ardhurave nga subjekti dhe personi i lidhur/bashkëshorti, në deklaratat periodike vjetore sipas konstatimeve më sipër, për sa kohë që provohet burimi i ligjshëm i tyre e përjashtojnë rrezikun e gjendjes në situatën e parashikuar nga germenat “b”, “c”, “ç” dhe “d”, të piëks 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

17 Analiza financiare gjatë viteve të deklarimit

17.1 Referuar deklaratës “Vetting” të vitit 2017, Komisioni analizoi pasuritë, të ardhurat, detyrimet, shpenzimet jetike sipas INSTAT (ILDKPKI) si më poshtë vijon:

⁴¹ Vërtetim, datë 12.6.2019, nga “Tirana Bank”.

Përshkrim	01.10.2004 - 31.12.2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	Total
Shtesa / pakësime likuiditetesh														0
Shtesa / pakësime të llogarive bankare	0	230,589	-212,294	-5,742	32,293	4,262	33,821	-7,542	-60,141	2,280,428	182,217	2,034,156	73,878	4,585,923
Shtesa / pakësime të gjendjes cash	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Total shtesa / pakësime likuiditetesh	0	230,589	-212,294	-5,742	32,293	4,262	33,821	-7,542	-60,141	2,280,428	182,217	2,034,156	73,878	4,585,923
Detyrime														0
Kredi bankare në Raiffeisen Bank, datë 25.04.2006			300,000											300,000
Kredi bankare në Raiffeisen Bank, datë 20.01.2011							312,000							312,000
Kredi bankare në Union Bank, datë 15.07.2014											70,000			70,000
Hua nga Gj.B., kunati I bashkëshortit të subjektit, datë 19.09.2012									279,440					279,440
Total detyrime	0	0	300,000	0	0	0	0	312,000	279,440	0	70,000	0	0	961,440
Të ardhura														0
Të ardhura nga pagat subjekti	193,155	917,133	883,728	369,344	776,109	917,125	882,517	949,726	128,235	876,192	1,185,933	1,183,388	1,173,991	10,436,576
Të ardhura nga pagesat e Sigurimeve për barrë lindje subjekti				326,780	55,127				610,984	43,259				1,036,150
Të ardhura nga pagat bashkëshortit		451,447	521,764	598,134	790,412	723,598	695,806	820,230	780,573	819,897	652,529	691,878	751,211	8,297,479
Të ardhura nga dëmshpërblim për vitet e burgut të të atit të bashkëshortit të subjektit							130,233			130,233				260,467
Të ardhura nga e ëma e b/shortit A.V. për pagesë për objektin "Shtëpia e Ushtarakëve"										494,805				494,805
Të ardhura e ëma e b/shortit A.V. nga shpronësimi sipas Vendimit nr. 855, datë 13.12.2006 i Këshillit të Ministrave											2,100,000	2,299,000		4,399,000
Të ardhura nga qiraja e një pjese të objektit "Shtëpia e Ushtarakëve", Himarë (52 m2)											0	16,667	40,000	56,667
Të ardhura nga qiraja e apartament me sip.71.11 m2 në Fier, lagjia "Konferenca e Pezës", Fier												2,667	13,000	15,667
Interesa bankare nga depozita në Veneto Banka, kontratë nr *****, datë 08.10.2013											103,950	45,424	44,625	193,999
Interesa bankare nga depozita në Credins Bank													32,265	32,265
Interesa bankare nga depozita në Procredit Bank në emër të K.V. (e bija), lekë dhe euro						2,494	5,419	2,647	2,594	3,369	2,260	365	645	19,794
Interesa bankare nga depozita në Tirana Bank			4,996	5,056	5,556	3,750	0							19,359
Të ardhura nga Bashkia Tiranë për të birin E.V.									5,000			5,000		10,000
Total të ardhura	193,155	1,368,580	1,410,488	1,299,314	1,627,204	1,646,968	1,713,975	1,772,603	1,527,386	4,467,755	1,944,672	4,244,388	2,055,737	25,272,226
Shpenzime														0
Shpenzime për blerje pasurie "Shtëpia e Ushtarakëve" në Himarë										616,481				616,481
Shpenzime shlyerje këste kredish Raiffeisen Bank			90,377	126,565	127,448	42,630	0	161,800	179,760	31,823	0	0		760,402
Shpenzime shlyerje këste Union Bank											31,922	44,601		76,523
Shpenzime shkollimi për fëmijët	0	0	0	0	0	0	0	0	0	70,000	175,000	242,750	319,750	807,500
Shpenzime jetese sipas anketës së buxhetit të familjes INSTAT	78,924	556,044	556,044	788,268	791,376	788,268	860,844	860,844	944,568	944,568	944,568	953,484	982,740	10,050,540
Shpenzime për arredim të shtëpisë	0	0	26,406	26,406	26,406	26,406	26,406	26,406	26,406	26,406	26,406	26,406	26,406	290,463
Shpenzime dieta bashkëshortit	0	600	0	0	86,646	109,281	22,500	125,000	106,905	109,200	5,500	6,400	0	572,032
Shpenzime për udhëtime nga sistemi TIMS	0	159,302	461,412	0	117,023	168,719	180,453	96,810	0	47,671	0	294,571	54,108	1,580,070
Shpenzime për blerje Autoveturë tip Fiat Brava						120,000								120,000
Total shpenzime	78,924	715,946	1,134,239	941,239	1,148,899	1,255,304	1,090,203	1,270,860	1,257,638	1,846,149	1,183,395	1,568,212	1,383,004	14,874,011
Balanca e fondeve (Të ardhura-Pasuri+Detyrime-Shpenzime)	114,231	422,045	788,543	363,817	446,012	387,403	589,952	821,285	609,329	341,179	649,060	642,021	598,855	6,773,732

17.2 Në lidhje me analizën financiare, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar me saktësi pasuritë, detyrimet dhe të ardhurat e tij dhe ka burime të ligjshme për krijimin e tyre.

17.1 Konkluzioni për kriterin e vlerësimit të pasurisë

Në përfundim, trupi gjykues, bazuar në parimin e objektivitetit dhe proporcionalitetit, barazisë së palëve, si dhe duke respektuar të drejtat themelore të subjektit të rivlerësimit, në lidhje me rubrikën e vlerësimit të pasurisë, arrin në përfundimin se nga kontrolli i pasurisë ndaj subjektit të rivlerësimit nuk u evidentuan pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht, subjekti ka kryer deklarim të saktë dhe në përputhje me ligjin, ka pasur burime financiare të ligjshme e të mjaftueshme për krijimin e pasurisë, nuk ka kryer deklarim të rremë apo fshehje të pasurisë. Subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.

VI. PROCESI I RIVLERËSIMIT TË KONTROLLIT TË FIGURËS

1. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjekti të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim DSIK-ja ka dërguar një raport me shkresën nr. *** prot., datë 30.10.2017, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 24.1.2019, të KDZH-së, për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39, të ligjit nr. 84/2016.

2. Sipas këtij raporti, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklarimit për kontrollin e figurës, si dhe nuk ka informacione se subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar.

3. Si konkluzion, Grupi i Punës konstaton përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit znj. Klodiana Veizi.

4. Pavarësisht nga raporti i dërguar nga DSIK-ja, Komisioni ka kryer hetim administrativ nga ku rezulton se konstatimet e Grupit të Punës për kontrollin e figurës janë të sakta.

5. Më tej, Komisioni konstaton se nuk ka asnjë informacion apo indice që të implikojë subjektin në kryerjen e ndonjë vepre penale apo cenim të figurës, nuk ka denoncime apo të dhëna të tjera që të rezultojnë se subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH, të Aneksit të Kushtetutës, dhe në ligjin nr. 84/2016.

6. Në përfundim, Komisioni çmon se subjekti i rivlerësimit e ka dorëzuar deklaratën për figurën në kohën e përcaktuar nga ligji nr. 84/2016, nuk ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar dhe nuk ka bërë deklarim të pamjaftueshëm në lidhje me kontrollin e figurës, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës. Subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

VII. PROCESI I RIVLERËSIMIT PËR AFTËSITË PROFESIONALE

Këshilli i Lartë Gjyqësor, si organi ndihmës për vlerësimin profesional, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” ka dorëzuar raportin profesional për subjektin e rivlerësimit.

Nga vlerësimi i tri dokumenteve të përzgjedhura nga subjekti dhe i pesë dosjeve të përzgjedhura me short, janë vënë re këto gjetje lidhur me kriteret e vlerësimit, sipas ligjit nr. 96/2016:

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Klodiana Veizi, ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Ajo identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye për mënyrën e zbatimit të saj në çdo rast. Ka njohuri të qarta për rëndësinë e natyrës së mosmarrëveshjes lidhur me zgjidhjen e çështjes, ka koncepte të qarta procedurale të gjykimit administrativ, ku diferencon veprimet përgatitore që kryhen nga gjyqtari pa pjesëmarrjen e palëve, nga seanca përgatitore me pjesëmarrjen e palëve, si dhe rendin e veprimeve përgatitore.
2. Në përgjithësi, në vendimet e saj gjyqësore, shënon shprehimisht parimet e përgjithshme të teorisë të së drejtës, siç janë: *“titulli më i fortë”*, *“përplasja e titujve”*, *“parimi i sigurisë juridike”* dhe *“vendimeve të formës së prerë dhe të ekzekutueshëm”* si dhe *“e drejta e pronës”* dhe *“e drejta e shpërblimit të drejtë”*. Pothuajse në të gjitha rastet, në funksion të interpretimit të ligjit, ka përdorur referenca në jurisprudencën unifikuese të Gjykatës së Lartë dhe në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese.
3. Tri dokumentet e përzgjedhura prej saj dhe pesë dosjet gjyqësore konfirmojnë njohuritë në të drejtën civile, penale dhe administrative, ku bien në sy regjimi i bashkëpronësisë midis bashkëshortëve, marrëdhëniet e punës, elementet e veprave penale të vjedhjes dhe të shitjes së narkotikëve, aktet administrative në fushën e tatimeve, vlera e kompensimeve për pasuritë e paluajtshme të shpronësuara dhe aktet për regjistrimin e pasurive të paluajtshme.
4. Nga ana tjetër, ndër tri dokumentet ligjore dhe pesë dosjet e vëzhguara, janë ankimuar 6 prej tyre. Në pesë raste vendimet janë lënë në fuqi nga shkalla e dytë e gjykimit, ndërsa në një rast, ende nuk ka përfunduar shqyrtimi i ankimit nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë. Nga dokumentet e administruara nuk rezulton asnjë çështje e prishur apo ndryshuar nga shkalla e dytë e gjykimit.
5. Gjatë periudhës së rivlerësimit, për gjyqtaren Klodiana Veizi janë verifikuar nga Inspektorati i KLD-së dy ankesa: një ankesë e vitit 2015 për vonesë në zbardhjen e vendimit, është sugjeruar tërheqje e vëmendjes me shkrim gjyqtares, ndërsa ankesa tjetër e vitit 2016 e verifikuar për dy ditë vonesë në zbardhjen e vendimit, i është regjistruar gjyqtares për efekt vlerësimi profesional dhe etik.
6. Vendimet gjyqësore përfundimtare të arsyetuara nga gjyqtarja Klodiana Veizi përmbajnë strukturën e përcaktuar nga legjislati procedural. Ajo respekton rregullat e drejtshkrimit dhe përdor të gjitha karakteret e gjuhës shqipe, në funksion të qartësisë së arsyetimit të vendimit gjyqësor. Arsyetimin e vendimit e strukturon në paragrafë të evidentuar dhe sipas argumentit që merr në analizë.
7. Struktura e vendimeve të saj është gjithmonë e standardizuar. Përmbajtja e vendimit është gjithëpërfshirëse dhe i jepet përgjigje pretendimeve të palëve. Në tekstet e vendimit ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtarja. Në nxjerrjen e konkluzioneve i kushton rëndësi analizës së normës ligjore, si dhe arsyetimit të vendimeve të ndërmjetme, duke referuar edhe shkakun ligjor.
8. Nga vëzhgimi i pesë dosjeve të shortuara është konstatuar se gjyqtarja Klodiana Veizi i ka kushtuar rëndësi arsyetimit në kohën e duhur të vendimeve gjyqësore, me tejkalime tepër të vogla, 1 – 2 ditë nga afati ligjor.
9. Subjekti i rivlerësimit, znj. Klodiana Veizi, ka aftësi për të kryer procedurat gjyqësore. Dosjet e vëzhguara janë vënë në lëvizje pa vonesa prej saj, përmes vendimeve formale për caktimin e seancës përgatitore apo gjyqësore. Në katër çështje administrative themeli të

vëzhguara, ka kryer veprimet përgatitore, të cilat janë dokumentuar rregullisht me procesverbal dhe efektiviteti i tyre ka qenë në nivelin e duhur.

10. Dokumentacioni në pesë dosjet e vëzhguara në përgjithësi është i rregullt dhe aktet e krijuara apo të vlerësuara nga subjekti në shumicën e tyre janë të sakta nga ana formale. Procesverbalet që dokumentojnë veprimet përgatitore apo seancat gjyqësore përgjithësisht janë të plota, duke dokumentuar palët pjesëmarrëse dhe veprimet e kryera, sipas kërkesave të ligjit procedural.

11. Sipas të dhënave të regjistrimit të procedimeve disiplinore, për gjyqtaren Klodiana Veizi përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore.

12. Konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm. Në asnjë rast nga tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e tjera të vëzhguara, nuk janë konstatuar raste ku subjekti i rivlerësimit, znj. Klodiana Veizi, nuk ka respektuar rregullat procedurale që lidhen me standardin e gjykatës së paanshme.

Konkluzione për rivlerësimin e aftësive profesionale

13. Trupi gjykues vlerëson se në bazë të të gjitha rrethanave dhe kushteve të mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të mira në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve, është eficient dhe efektiv dhe konsiderohet “i aftë”.

14. Trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

VI. DENONCIMET NGA PUBLIKU

Në Komision për subjektin e rivlerësimit, znj. Klodiana Veizi, janë administruar shtatë denoncime nga publiku, si më poshtë vijon:

1. Denoncimi nr. *** prot., datë 19.3.2018 i shtetasit G. Z., i cili denoncon subjektin e rivlerësimit se ka zgjatur gjykimin e çështjes, seancat janë shtyrë pa arsye, gjyqtarja ka qëndruar në zyrën e saj rreth 20 minuta me përfaqësuesen e palës tjetër.

2. Denoncimi nr. *** prot., datë 14.5.2018 i i shtetasit M. B., i cili e denoncon subjektin e rivlerësimit për korrupsion, paaftësi profesionale dhe për zbardhje me vonesë të vendimit.

3. Denoncimi nr. *** prot., datë 27.6.2018 i shtetasit A. S., i cili e denoncon subjektin e rivlerësimit se ka pasur gjykim të njëanshëm, ka dyshime për ndërhyrje, janë zhvilluar 26 seanca gjyqësore dhe është dhënë një vendim i padrejtë.

4. Denoncimi nr. *** prot., datë 13.7.2018 i shtetasit A. Sh., i cili e denoncon subjektin e rivlerësimit për veprime korruptive, anulimin dhe shtyrjen e seancës gjyqësore për shkaqe të rreme dhe vonesën në dorëzimin e dosjes në sekretari pas marrjes së konfirmimit të ankimit nga palët në gjykim.

5. Denoncimi nr. *** prot., datë 15.11.2018 i shtetasit H.P., i cili e denoncon subjektin e rivlerësimit për parregullsi procedurale në zhvillimin e procesit gjyqësor dhe vonesë në zbardhjen e vendimit.

6. Denoncimi nr. *** prot., datë 26.12.2018 i shtetasit A.M., i cili e denoncon subjektin e rivlerësimit se ka dhënë vendim të gabuar.

7. Denoncimi nr. *** prot., datë 19.2.2019 i shtetasit Z.G., i cili denoncon subjektin e rivlerësimit për zhvillimin e një gjyqi farsë.

Pasi mori në shqyrtim ankesat e depozituara nga publiku, raportin e vlerësimit të KLGJ-së⁴² lidhur me denoncimet e administruara, si dhe të gjitha aktet e tjera ligjore, në lidhje me denoncimet e mësipërme, nga Komisioni konstatohet se: për një denoncim nuk ka indice dhe prova të provohen faktet e pretenduara (shtetasi G. Z.); për katër denoncime vendimi është depozituar brenda afatit 7-ditor të përcaktuar nga pika 3, e nenit 42, e ligjit nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, si dhe nuk ka indice dhe prova të provohen faktet e pretenduara (shtetasi M. B.; A. S.; A. SH.; H. P.); një prej denoncimeve lidhet me mënyrën e zgjidhjes së çështjes në themel (shtetasi A. M.); dhe një denoncim rezulton të jetë një ndër pesë dosjet e përzgjedhura me short dhe është analizuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor në raportin për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit dhe nuk provohen faktet e pretenduara (shtetasi Z.G.).

Komisioni konkludoi se nuk ka prova për të provuar pretendimet e denoncuara, për gjetje thelbësore që do të ndikonin në vlerësimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit. Në disa raste, faktet dhe shkaqet për të cilat bëhen ankesat lidhen me bazueshmërinë në ligj dhe në prova të vendimit gjyqësor, të cilat kontrollohen dhe vlerësohen nga gjykatat e nivelit më të lartë dhe këto raste nuk janë objekt shqyrtimi nga Komisioni në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Për sa më sipër, Komisioni, pasi kreu hetim të hollësishëm për këto denoncime dhe pasi u shqyrtuan, në mbështetje të nenit 53, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, arriti në përfundimin se këto denoncime nuk përmbajnë fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit.

VIII. KONKLUZIONI PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, znj. Klodiana Veizi, ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

- Ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.
- Ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.
- Ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale sipas parashikimit të germës “c”, të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, dhe referuar germës “a”, të pikës 1, të nenit 58, si dhe pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Klodiana Veizi, gjyqtare pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës.
2. Vendimi i arsyetuar me shkrim u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, 30 ditë pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në

⁴² Shkresa nr. ***, datë 11.6.2019 e KLGJ-së.

faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.

3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 21.6.2019.

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Pamela QIRKO

Kryesuese

Brunilda BEKTESHI

Anëtare

Etleđa ÇIFTJA

Relatore

Sekretare gjyqësore

Olsida Goxhaj